



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 34 regjistër (JR)  
Datë 13.11.2018

Nr. 27 i vendimit  
Datë 24.10.2019

**VENDIM**  
**NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Kryesuese</b>
<b>Sokol Çomo</b>	<b>Relator</b>
<b>Luan Daci</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ardian Hajdari</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 24.10.2019, ora 15:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në Tiranë, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Elka Ermenkova, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 34 (JR), datë 13.11.2018, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Darjel Sina.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 62, datë 03.08.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit Artur Malaj.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 62, datë 03.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit për subjektin e rivlerësimit Artur Malaj dhe shkarkimin e tij nga detyra, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Artur Malaj, i cili përfundimisht kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit prej vitit 2002 e në vijim ka ushtruar detyrën e gjyqtarit dhe në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit nr. 84/2016 ushtronte detyrën e gjyqtarit në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë, për rrjedhojë ai gëzonte statusin e magjistratit<sup>1</sup>. Duke qenë se subjekti i rivlerësimit ishte kandidat për Inspektor të Lartë të Drejtësisë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 282, pika 1 e ligjit nr. 115/2016<sup>2</sup> “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, ai iu nënshtrua procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio* dhe me përparësi në kohë.
2. Subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor<sup>3</sup>, në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 përkatësisht deklaratën e pasurisë<sup>4</sup>, deklaratën për kontrollin e figurës<sup>5</sup>, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional<sup>6</sup>.
3. Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se:
  - (i) *Deklarimi është i saktë, në përputhje me ligjin.*
  - (ii) *Ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.*
  - (iii) *Nuk ka kryer fshehje të pasurisë.*
  - (iv) *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
  - (v) *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*
4. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarameve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit kishte kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016, dhe dërgoi një raport pranë Komisionit, bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016. Në raportin e saj, DSIK-ja përcaktoi se subjekti i rivlerësimit ka plotësuar formularin e deklaramit për kontrollin e figurës në mënyrë të saktë, të plotë dhe në

<sup>1</sup> Neni 2, pika “gj” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” parashikon se magjistrat është edhe gjyqtari, ndërkohë neni 164, pika 2 e të njëjtit ligj parashikon se gjyqtarët në detyrë gëzojnë statusin e magjistratit të parashikuar sipas të njëjtit ligj, vetëm nëse kalojnë me sukses procesin e rivlerësimit.

<sup>2</sup> Neni 282, pika 1 e ligjit nr. 115/2016 parashikon:

1. Gjyqtari ose prokurori ose subjektet e tjera, të cilët i nënshtrohen procedurës së rivlerësimit dhe që janë të interesuar për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, brenda një muaji nga krijimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i paraqesin Komisionit një shkresë ku shprehin interesin për pozicionin e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë [...]. Rivlerësimi i tyre bëhet me përparësi menjëherë me krijimin e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

<sup>3</sup> Afati ligjor prej 30 ditësh nga hyrja në fuqi e ligjit për dorëzimin e deklaramit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe formularit të vetëvlerësimit profesional, ka përfunduar më datë 31.01.2017.

<sup>4</sup> Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 30.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {\*\*\*} prot., datë 30.01.2017, vetë deklarama nuk ka datë të shënuar në rubrikën përkatëse.

<sup>5</sup> Dorëzuar pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, më datë 25.01.2017

<sup>6</sup> Dorëzuar pranë Këshillit të Lartë të Drejtësisë, më datë 25.01.2017, provuar kjo sipas procesverbalit të së njëjtës datë, me nr. prot {\*\*\*}, datë 25.01.2017.

përputhje me parashikimet e ligjit nr. 84/2016, dhe se lidhur me të administrohen informacione nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, kryesisht atë të korrupsionit për shkak të funksionit, si dhe implikimin e tij në kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar. Për rrjedhojë, DSIK-ja konstatoi papërshtatshmërinë e subjektit të rivlerësimit Artur Malaj për vazhdimin e detyrës.

5. Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të 5 dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, dhe ka dërguar pranë Komisionit një raport të hollësishëm për subjektin e rivlerësimit, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.
6. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin në fjalë, bazuar në të tria kriteret e vlerësimit (vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale), duke marrë vendimin nr. 62, datë 03.08.2018.

## **II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit**

7. Komisioni, me vendimin nr. 62, datë 03.08.2018, vendosi: “Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Apelit, Tiranë. [...]”.
8. Ky vendim është marrë bazuar në nenet 58, pika 1, shkronja “a” dhe 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, për secilin prej tri kriterëve të rivlerësimit.

*8.1 Në lidhje me vlerësimin e pasurisë së subjektit, duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklarimet e pasakta të konstatuara gjatë hetimit administrativ nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit; pasaktësitë e konstatuara nuk çmohen se cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut të drejtësisë; subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe i ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të. Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij, si dhe nuk rezulton të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme. Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë. Ai nuk është përprjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij, për rrjedhojë në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj, nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.*

*8.2 Në lidhje me kontrollin e figurës, nga hetimi administrativ në tërësi lidhur me raportin e DSIK-së, konstatohet se informacioni i përcjellë nuk përmban elementet e parashikuara nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016 dhe ai konsiderohet i paplotë [...]. Në këto kushte, duke analizuar raportin e ardhur nga DSIK-ja dhe organet ligjzbatuese, duke bërë një studim të thelluar të tyre, duke administruar provat e tjera në lidhje me çështjen, çmohet se informacioni mbi të cilin ka ardhur rekomandimi i DSIK-së rezulton i pasaktë dhe i pabazuar në prova dhe fakte, për pasojë subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, konsiderohet i përshtatshëm për vazhdimin e detyrës.*

**8.3** Në lidhje me vlerësimin e aftësive profesionale, në përfundim të hetimit, mbështetur në raportin e KLD-së, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve, u konstatua se ky subjekt ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe, për rrjedhojë, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, z. Artur Malaj, mund të konsiderohet “i aftë”.

### III. Shkaqet e ankimit

9. Komisioneri Publik Darjel Sina, më datë 26.10.2018, në konsideratë edhe të “Rekomandimit për paraqitje ankimi<sup>7</sup>” të tre vëzhguesve ndërkombëtarë të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit (në vijim referuar “ONM”), të depozituar pranë Institucionit të Komisionerëve Publikë, më datë 10.08.2018, ushtroi ankim ndaj vendimit të Komisionit nr. 62, datë 03.08.2018, për subjektin e rivlerësimit Artur Malaj, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke pretenduar vlerësim të gabuar nga ana e Komisionit të këtij kriteri. Sipas Komisionerit Publik, referuar provave dhe gjetjeve nga hetimi administrativ, në raport me dokumentet dhe pretendimet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, ky i fundit nuk ka deklaruar saktë dhe mjaftueshëm pasuritë, nuk ka përmbushur detyrimin ligjor të përcaktuar në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nuk ka arritur të provojë të kundërtën e parashikimeve të pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, ndaj kundër tij duhet të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit. Referuar nenit 52 të ligjit nr. 84/2016 (barra e provës), subjekti nuk ka arritur të provojë me prova dhe shpjegime bindëse të kundërtën e rezultateve të hetimit, rrjedhimisht, edhe përfundimet e arritura nga Komisioni për vlerësimin e pasurisë së subjektit, sipas Komisionerit Publik, nuk gjenden të drejta.
10. Komisioneri Publik nuk krijoi bindjen se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pronat në përdorim, posedim apo disponim të tij dhe të personave të lidhur dhe, në vlerësimin e tij, subjekti është përpjekur të fshehtë pasurinë dhe nuk ka arritur të argumentojë burimin e ligjshëm të pasurive dhe të ardhurave të krijimit të tyre nga personat e tjerë të lidhur, me qëllim arritjen e një niveli të besueshëm të vlerësimit të pasurisë, sipas nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe në përfundim të gjyqimit, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë:
  - ° ndryshimin e vendimit nr. 62, datë 03.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artur Malaj.
11. Në datën 04.07.2019, Komisioneri Publik bëri kërkesë<sup>8</sup> për rivendosje në afat të së drejtës për ankim për një shkak të ri, të bazuar në fakte të panjohura më parë, duke e shoqëruar atë edhe me

<sup>7</sup> Bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “c” e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, të cilët parashikojnë shprehimisht si më poshtë:

- Neni B, pika 3, shkronja “c” e Aneksit të Kushtetutës:

Vëzhguesi ndërkombëtar ushtron këto detyra: [...] u jep Komisionerëve Publikë rekomandime me shkrim për të paraqitur ankim. Në rast se Komisioneri Publik nuk i zbaton rekomandimet, ai përgatit një raport me shkrim duke dhënë arsyet e refuzimit.

- Neni 65, pika 2 e ligjit nr. 84/2016:

Vëzhguesi ndërkombëtar ka të drejtë të paraqesë rekomandim me shkrim Komisionerit Publik, për të paraqitur ankim. Ky rekomandim jepet nga një komision i përbërë nga të paktën 3 përfaqësues të Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit.

<sup>8</sup> Kërkesa për rivendosje në afat të së drejtës për të ushtruar ankim së bashku me shtesën e ankimit të Komisionerit Publik, në përputhje me parashikimet e neneve 63 dhe 67 të ligjit nr. 84/2016, u depozituan nga Komisioneri Publik

aktin “Shtesë ankimi të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 62, datë 03.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”. Kjo kërkesë, sipas Komisionerit Publik, bazohet në nenin 67 të ligjit nr. 84/2016 dhe i referohet faktit të panjohur më parë prej tij, deri në paraqitjen në datën 20.06.2019 nga vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së, të gjetjes se ka prova të faktit<sup>9</sup> që Komisioni ka kryer analizë financiare për çështjen e rivlerësimit që i përket subjektit Artur Malaj, analizë e cila është përdorur nga Komisioni, por as Komisioneri Publik dhe as Kolegji nuk e kanë marrë këtë dokument në përmbajtje të dosjes zyrtare të Komisionit. Për rrjedhojë, në kuadër të sa më sipër, Komisioneri Publik i kërkoi Kolegjit kryerjen e një analize të plotë dhe përfundimtare financiare, në vlerësim të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit Artur Malaj. Kërkesa e Komisionerit Publik për rivendosje në afat të së drejtës për ankim dhe shtesa e ankimit iu përcollën subjektit të rivlerësimit para fillimit të shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, duke i dhënë mundësinë të njihet dhe të dëgjohet lidhur me to në seancë gjyqësore publike.

12. Shkaqet e ankimit dhe shtesës së ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurive, paraqiten në mënyrë të përmbledhur, si më poshtë.

**12.1** *Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm lidhur pasurinë “apartament banimi, me sipërfaqe 106,7m<sup>2</sup>, me adresë: rruga “{\*\*\*}” (ish-{\*\*\*}), Tiranë”, cilësuar në ankim si Pasuria 1 (referuar në vijim si “apartamenti i banimit”), duke mos përmbushur detyrimet e pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, pasi sipas Komisionerit Publik, subjekti nuk arriti të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, si dhe ka dhënë informacione kontradiktore dhe të pavërteta, duke bërë deklarime fiktive.*

**12.2** *Komisioni duhet të kishte kualifikuar si “persona të tjerë të lidhur”, në kuptim të pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, z. A. dhe znj. E.G. (respektivisht, kunatin dhe motrën e subjektit të rivlerësimit), si dhe z. F.B. (nipin e subjektit të rivlerësimit), të cilët së bashku me subjektin e rivlerësimit duhet të justifikonin burimin e pasurisë së tyre me të ardhura të ligjshme. Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit, pas kalimit të barrës së provës nga Komisioni, nuk arriti të provojë të kundërtën dhe të justifikojë bindshëm krijimin e pasurisë së personave të tjerë të lidhur me të ardhura të ligjshme.*

**12.3** *Komisioni ka gabuar në vlerësimin e rezultateve të hetimeve të kryera prej tij, lidhur me vilën 3-katëshe, të ndodhur në afërsi të shkollës “{\*\*\*}”, Vlorë, për të cilën Komisioneri Publik pretendon se subjekti është përpjekur të fshehtë pasuritë e tij, sjellje kjo për të cilën, referuar nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, parashikohet prezumimi në favor të masës disiplinore të shkarkimit.*

**12.4** *Verifikimi i mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të justifikuar krijimin e pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë vetting, për të cilat Komisioneri Publik pretendon se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, krahas pamjaftueshmërisë për mbulimin me burime të ligjshme të pagesës së këstit të parë për prenotimin e apartamentit të banimit në vitin 2005, nuk mbulojnë me burime të ligjshme*

---

*pranë Komisionit, me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 04.07.2019, i cili i përcolli në Kolegj me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 05.07.2019.*

<sup>9</sup> *Referenca në poshtëshënimin nr. 10 të vendimit të Komisionit nr. 62, datë 03.08.2018, “Nga analiza financiare e bërë”, dokumentet (Shtojca A) marrë nga ONM më datë 6 qershor 2019 nga relatori i çështjes në Komision, të cilat tregojnë analizën financiare të Komisionit dhe të dhënat thelbësore të çështjes, si dhe një tjetër version të analizës financiare të Komisionit, së bashku me të dhënat thelbësore të çështjes (Shtojca B), i gjetur në arkivin e ONM-së.*

shpenzimet e kryera dhe kursimet e deklaruara për vitet 2007, 2008, 2009 dhe 2011, në një diferencë negative prej 1.295.093 lekësh<sup>10</sup>.

#### IV. Gjetjet e paraqitura nga vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së

13. Në datën 15.11.2018 vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “b”, nenin F, pikat 3 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 49, pikat 10 dhe 12 të ligjit nr. 84/2016, depozitoi pranë Kolegjit kërkesën për të marrë prova dhe paraqitur gjetje. Nëpërmjet kësaj kërkesë, vëzhguesi ndërkombëtar kërkoi hetimin e informacioneve/denoncimeve<sup>11</sup> (bashkëlidhur kërkesës), të cilat kishin mbërritur pranë organeve të rivlerësimit pas dhënies së vendimit përfundimtar nga Komisioni dhe marrjen e provave në këtë drejtim, si dhe rekomandoi Kolegjin të marrë në shqyrtim dhe të vlerësojë vlefshmërinë dhe ekzistencën e një standardi ligjor të vendosur nga Kolegji me vendimin e tij nr. 4 (JR), datë 26.07.2018, për të cilin vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së depozitoi gjetjen në kuptim të nenit 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës *një vlerësim tërësor është i mundur në një rast kur shkarkimi nga detyra është bazuar vetëm në një kriter vlerësimi, atë të kontrollit të pasurisë*.
14. Në datën 20.06.2019<sup>12</sup>, vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “b” dhe nenin F, pikat 3 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, paraqiti pranë Kolegjit gjetjen që një fakt ka ekzistuar apo ka ndodhur, sipas së cilës shtojcat A dhe B bashkëlidhur saj janë prova të faktit që Komisioni ka kryer analizë financiare për çështjen e rivlerësimit që i përket subjektit Artur Malaj, por as Komisioneri Publik dhe as Kolegji nuk i kanë marrë këto dokumente në përmbajtje të dosjes zyrtare të Komisionit.
15. Në datën 28.08.2019, vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së, bazuar në nenin B, pika 3, shkronja “b” dhe nenin F, pikat 3 dhe 4 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 49, pika 10 e ligjit nr. 84/2016, paraqiti pranë Kolegjit në cilësinë e gjetjes gjashtëmbëdhjetë fotografi (të printuara) të një pasurie të paluajtshme të ndodhur në {\*\*\*}, lagjja {\*\*\*}, Vlorë, objekt shqyrtimi në këtë çështje gjyqësore dhe që ka të bëjë me seancën e intervistimit të znj. A.D. nga Komisioni, më datë 23.04.2018.
16. Të tria gjetjet e paraqitura nga vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së iu përcollën palëve në gjykim, me qëllim garantimin e të drejtës së tyre për proces të rregullt ligjor, duke iu dhënë mundësinë të njihen dhe të dëgjohen lidhur me to në seancë gjyqësore publike.

#### V. Kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit

17. Subjekti i rivlerësimit, në datën 05.11.2018<sup>13</sup>, i është drejtuar Kolegjit me *Kundërankim* ndaj ankimit të Komisionerit Publik, duke parashtruar se ky apel kundërshtues lidhet vetëm me kriterin e pasurisë dhe vetëm me ato çështje të vlerësimit të pasurisë që ka ankimuar Komisioneri Publik.
18. Kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit në *Kundërankimin* e tij ndaj shkaqeve të ankimit, parashtrohen në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

<sup>10</sup> Referuar analizës financiare të paraqitur nga Komisioneri Publik me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019, në mbështetje të kërkesës së tij për rivendosije në afat të një shkaku të ri të ankimit (shitesës së ankimit).

<sup>11</sup> Denoncimi i znj. L.K. dhe z. N.K., regjistruar në Kolegji me nr. {\*\*\*} prot., datë 23.08.2018 dhe ankesë-kallëzim penal i z. A.B., datë 04.11.2017, regjistruar në Operacionin Ndërkombëtar të Monitorimit me nr. {\*\*\*} prot., datë 07.08.2018.

<sup>12</sup> Me shkresën e Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit nr. {\*\*\*}, datë 20.06.2019, protokolluar në Kolegji me nr. {\*\*\*} prot., datë 20.06.2019.

<sup>13</sup> Protokolluar në Komision me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 05.11.2018.

**18.1** Lidhur me shkakun e ankimit sipas paragrafit 12.1 më sipër, subjekti pretendoi deklarim të saktë të apartamentit të banimit në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2005, si dhe në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe se, mospërputhjet e konstatuara sipas rezultatit të hetimeve nga Komisioni, vijnë si pasojë e veprimeve juridike të mëvonshme (akti “Revokim kontrate” i datës 22.07.2005, si dhe “Aktmarrëveshja dhe procesverbali i marrjes në dorëzim” i datës 15.05.2008) me anë të të cilave, me të parin është bërë *nul* kontrata e sipërmarrjes së lidhur në vitin 2005, ndërsa me anë të aktit të dytë është përcaktuar vlera përfundimtare e shitjes së apartamentit të banimit. Gjithashtu, subjekti pretendoi se pikërisht për këtë shkak, është i pabazuar edhe pretendimi i Komisionerit Publik për mungesë të burimeve të ligjshme për të krijuar këtë pasuri, duke qenë se pagesat e pretenduara sipas kontratës së sipërmarrjes nuk janë kryer prej tij. Në përfundim, subjekti pretendoi se ky shkak ankimi nuk qëndron, pasi veprimet juridike në lidhje me krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme janë kryer në përputhje me legjislacionin civil dhe se qëllimi i subjektit të rivlerësimit nuk ka qenë përcaktimi i çmimit fiktiv të blerjes së pasurisë.

**18.2** Lidhur me shkakun e ankimit sipas paragrafit 12.2 më sipër, subjekti parashtroi se pretendimi i Komisionerit për përcaktimin e tre personave, të afërm të subjektit, si “persona të tjerë të lidhur”, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, është pretendim i pabazuar në ligj, duke qenë se marrëdhëniet e subjektit me këta persona nuk përputhen me rastet e përcaktuara në mënyrë shteruese në dispozitën e sipërcituar ligjore. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka përmbushur barrën e provës dhe ka provuar burimet e ligjshme të pasurisë së këtyre tre personave, edhe pse në hetimin e tyre nga Komisioni dhe kalimin e barrës së provës subjektit, për gjetjet lidhur me këto pasuri, Komisioni ka kapërcyer kompetencat e tij ligjore.

**18.3** Sa i takon pretendimit të Komisionerit Publik sipas paragrafit 12.3 më sipër, lidhur me vlerësimin e gabuar nga Komisioni i rezultateve të hetimit lidhur me vilën 3-katëshe, të ndodhur në afërsi të shkollës “{\*\*\*}”, Vlorë, subjekti parashtroi se pretendimi i Komisionerit se kjo mund të jetë pasuri e fshehur e tij, është pretendim i pabazuar në prova, por vetëm në indicie, për verifikimin e të cilave janë administruar prova nga Komisioni, përfshirë ato të paraqitura nga subjekti, me anë të të cilave provohet e kundërta e pretendimit të Komisionerit Publik dhe rrëzohen indiciet e parashtruara, fillimisht nga Komisioni, në rezultatet e hetimit administrativ e në vijim, nga Komisioneri Publik në ankim.

19. Në përfundim, në kundërankimin e tij subjekti i rivlerësimit kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 62, datë 03.08.2018.
20. Lidhur me kërkesën e Komisionerit Publik për rivendosje në afat të së drejtës për ankim, për një shkak të ri, të bazuar në fakte të panjohura më parë dhe shtesën e ankimit, subjekti i rivlerësimit pretendoi se referuar neneve 63 dhe 67 të ligjit nr. 84/2016, rivendosja në afat e ankimit mund të bëhet vetëm në rastet kur Komisioneri Publik nuk ka bërë ankim dhe provon se e ka humbur këtë afat për shkaqe legjitime dhe të arsyeshme, por jo në rastin kur e drejta e ankimit është ushtruar. Gjithashtu, sa i takon përmbajtjes së kërkesës për rivendosje në afat dhe shtesës së ankimit, subjekti i rivlerësimit kundërshtoi kërkimet e Komisionerit Publik si të pabazuara, me pretendimin se konkluzionet e Komisionerit mbi mospërputhjet në deklarime të subjektit të rivlerësimit janë pretendime të ngritura më parë nga Komisioni, për të cilat subjekti ka dhënë shpjegime në dokumentin e titulluar “Shpjegime, kundërshtime dhe prova, lidhur me relacionin përfundimtar të hetimit administrativ” dhe, për rrjedhojë, Komisioneri Publik nuk mund të rivendoset në afat lidhur me fakte për të cilat ka qenë në dijeni të tyre, pasi ato janë pjesë e dosjes gjyqësore. Për më tepër, sipas subjektit të rivlerësimit, Shtojcat A dhe B të paraqitura bashkëlidhur gjetjes nga vëzhguesi

ndërkombëtar, nuk janë prova, nuk janë administruar si të tilla nga Komisioni në dosje dhe nuk mund të kenë ndikuar në vendimmarrjen e tij.

21. Subjekti i rivlerësimit i kërkoi trupit gjykues mospranimin e kërkesës për rivendosje në afat të së drejtës për të ushtruar ankim kundrejt një shkakut të panjohur më parë, pasi sipas tij kjo kërkesë është e papabuar në ligj dhe shtesa e ankimit e pajustificuar.
22. Në fazën procedurale të bisedimeve përfundimtare, subjekti i rivlerësimit ngriti pretendimin për cenim të procesit të rregullt ligjor, në drejtim të:
  - (i) cenimit të parimit të gjykimit nga një gjykatë e pavarur, si pasojë e kapërcimit nga gjykata të kufijve të shqyrtimit të çështjes, pasi Kolegji duke marrë atributet e ankuesit, pa kërkesë të palës ankuese dhe pa qenë pjesë e ankimit, ka shkuar tej kërkimeve të tij, duke kryer një analizë financiare për të gjitha vitet;
  - (ii) cenimit të së drejtës për t'u mbrojtur në mënyrë efektive si pasojë e mosprimit nga Kolegji të kërkesës për marrjen e provës me ekspert-kontabël të licencuar.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit solli në vëmendje të trupit gjykues faktin e të qenit anëtar i Kolegjit Zgjedhor dhe mbrojtjen e veçantë të parashikuar në nenin 149<sup>14</sup> të Kodi Zgjedhor për gjyqtarin, anëtar të Kolegjit Zgjedhor.

## VI. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

### A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

#### a) Juridiksioni i Kolegjit

23. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit të rivlerësimit Artur Malaj, duke e konfirmuar atë në detyrë, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

#### b) Legjitimitimi i ankuesit

24. Ankuesi legjitimohet *ratione personae* në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis* pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>15</sup> nga

<sup>14</sup> Neni 149 i Kodit Zgjedhor parashikon:

Gjyqtari i Kolegjit Zgjedhor nuk mund t'i nënshtrohet procedimit disiplinor gjatë gjithë periudhës për të cilën është krijuar kolegji.

Gjatë kësaj kohe, gjyqtarët e Kolegjit Zgjedhor të Gjykatës së Apelit Tiranë nuk mund të lëvizin nga detyra e gjyqtarit, për shkak që lidhen me nenin 32 të ligjit nr. 9877, datë 18.2.2008, "Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë", si dhe për pamjaftueshmëri profesionale. Ndaj tyre nuk mund të jepet vlerësimi "i paafte".

<sup>15</sup> Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 62, datë 03.08.2018, për rivlerësimin e subjektit Artur Malaj, i është njoftuar Institucionit të Komisionerit Publik më datë 11.10.2018, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., të së njëjtës datë, konfirmuar sipas lajmërim-marrjes së protokolluar pranë këtij institucioni



data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

25. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 62, datë 03.08.2018, për subjektin e rivlerësimit Artur Malaj, u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, të zhvilluara në prani të palëve, me përjashtim të seancës gjatë së cilës u shpall vendimi, në të cilën subjekti i rivlerësimit nuk ishte i pranishëm, megjithëse ishte njoftuar rregullisht.
26. Lidhur me kërkesën e Komisionerit Publik për rivendosje në afat të së drejtës për ankim, për një shkak të ri, të bazuar në fakte të panjohura më parë dhe shtimin e ankimit, kërkesë e cila u mor në shqyrtim në seancë gjyqësore publike para fillimit të shqyrtimit të ankimit, trupi gjykues, pasi dëgjoi shpjegimet e palëve, shqyrtoi gjetjen e paraqitur në datën 20.06.2019 nga vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së, arriti në përfundimin se ka prova të mjaftueshme të ekzistencës së një analize financiare, të kryer nga Komisioni për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të dhe mbi bazën e së cilës Komisioni ka arritur në vendimmarrje mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe se Komisioneri Publik, në momentin e ushtrimit të ankimit ndaj vendimit nr. 62, datë 03.08.2018, të Komisionit, nuk ka qenë në dijeni të këtij fakti. Mungesa e këtij akti thelbësor për vlerësimin e kriterit të pasurisë e ka vënë Komisionerin Publik në kushtet e pamundësisë për të ushtruar një ankim të plotë dhe efektiv ndaj vendimit të Komisionit, lidhur me kriterin e rivlerësimit në fjalë. Ndodhur në këto kushte, trupi gjykues çmon se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kërkesa e Komisionerit Publik nuk përmbush kriteret e përcaktuara në nenet 63 dhe 67 të ligjit nr. 84/2016, pasi Komisioneri Publik e ka ushtruar të drejtën e ankimit dhe, për rrjedhojë, nuk mund të rivendoset në afat për një shkak të ri, është i pabazuar. Në përfundim, trupi gjykues me vendim të ndërmjetëm<sup>16</sup>, bazuar në nenet 49, pika 10 dhe 67 të ligjit nr. 84/2016, pasi verifikoi edhe respektimin e afatit ligjor prej 15 ditësh<sup>17</sup> nga data e vënies në dijeni të Komisionerit Publik mbi gjetjen e paraqitur nga vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së, vendosi të pranojë kërkesën e Komisionerit Publik për rivendosjen në afat të së drejtës për ankim, duke i shtuar ankimit të tij, të datës 26.10.2018, edhe shkakun e ri të paraqitur nëpërmjet shkresës së Komisionerit Publik nr. {\*\*\*}, datë 04.07.2019.
27. Në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit drejtuar trupit gjykues për “riçeljen pjesërisht të hetimit gjyqësor duke paraqitur disa prova të reja”, si dhe në kuadër të kërkesës së Komisionerit Publik, sipas shtesës së ankimit, për kryerjen e një analize të plotë dhe përfundimtare financiare në vlerësim të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues, pasi dëgjoi shpjegimet

---

me nr. {\*\*\*} prot., datë 11.10.2018, kurse ankimi i Komisionerit Publik është depozituar pranë Komisionit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 26.10.2018, protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 26.10.2018, që rezulton të jetë dita e 15-të e afatit ligjor për të ushtruar ankim në përputhje me nenin 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

<sup>16</sup> Shih procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 19.07.2019.

<sup>17</sup> Komisionerit Publik, me anë të shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 21.06.2019, i është përcjellë nga Kolegji gjetja e ONM-së, përcjellë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 20.06.2019. Komisioneri Publik ka konfirmuar marrjen e gjetjes së sipërcituar më datë 21.06.2019 dhe më datë 04.07.2019, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., ka depozituar pranë Komisionit kërkesën me lëndë “Rivendosje në afat të së drejtës për të ushtruar ankim, kundrejt një shkakui të panjohur më parë dhe shtesë ankimi të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 62, datë 03.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, protokolluar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 04.07.2019, që rezulton të jetë dita e 13-të e afatit ligjor për të bërë kërkesë për rivendosje në afat, në përputhje me nenin 67, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

e palëve, në funksion të shqyrtimit të çështjes, me vendim të ndërmjetëm<sup>18</sup>, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, vendosi:

- (i) çeljen e hetimit gjyqësor;
- (ii) kryerjen nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Kolegjit të një analize të plotë, për sa i përket situatës financiare të subjektit të rivlerësimit, që nga viti 2003 deri në vitin 2016, dhe njoftimin e saj palëve në proces;
- (iii) të pranojë të merren si prova aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit;
- (iv) të pranojë të merret si pjesë integrale e shtesës së ankimit, shkresa e Komisionerit Publik nr. {\*\*\*} prot., datë 23.07.2019.

28. Në zbatim të vendimit të mësipërm të trupit gjykues, analiza ekonomiko-financiare<sup>19</sup> iu përcoll Komisionerit Publik dhe subjektit të rivlerësimit, duke iu dhënë atyre mundësinë të njiheshin dhe ta debatonin atë në seancë gjyqësore publike. Subjekti i rivlerësimit, në funksion të kësaj analize, kërkoi marrjen e disa provave të tjera shkresore, të cilat pasi u pranuan për shqyrtim nga trupi gjykues, u debatuan nga palët në seancë gjyqësore. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 49, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, në nenin 34 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, si dhe në nenet 224/a e vijues të Kodit të Procedurës Civile, kërkoi të merret prova me ekspert kontabël të licencuar dhe të regjistruar në regjistrin e Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim kryerjen e një analize financiare (akt ekspertimi kontabël) në të cilën të sqarohen çështjet për të cilat Komisioneri Publik ka pretendime. Lidhur me këtë kërkesë, trupi gjykues me vendim të ndërmjetëm, bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, vendosi të mos pranojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për kryerjen e një ekspertimi kontabël, pasi marrja e kësaj prove u çmua e panevojshme.

#### *B. Mbi pretendimet e subjektit të rivlerësimit për cenim të procesit të rregullt ligjor*

29. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për kapërcim të kufijve të shqyrtimit të çështjes në Kolegj, si pasojë e vendimmarrjes së trupit gjykues për kryerjen e një analize financiare për periudhën e viteve 2003-2016, pa kërkesë të Komisionerit Publik dhe përtej objektit të kërkimit të tij, trupi gjykues, nga shqyrtimi i dokumentacionit të fashikullit gjyqësor, konstatoi sa vijon.

29.1 Në dokumentin “Shtesë ankimi e Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 62, datë 03.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioneri Publik shprehet: *Në dritën e këtyre fakteve të reja, të vëna në dispozicion rishtazi, Komisioneri Publik ka kryer analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003-2016. [...] Nga analizimi i këtyre të dhënave, krahas pamjaftueshmërisë së mbulimit me burime të ligjshme për pagesën e këstit 1 të apartamentit në vitin 2005, analizuar në pikat 16, 17 të Ankimit të datës 26.10.2018, ka rezultuar se subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk mbulojnë me burime të ligjshme shpenzimet dhe kursimet e deklaruar edhe për vitet 2007, 2008, 2009, 2011, në një diferencë negative në shumën totale prej 1295.093 lekësh [...]. Në vlerësimin e Komisionerit Publik, deklaratimet e pasakta mbi kursimet “cash” ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare të subjektit dhe bashkëshortes së tij, për krijimin e pasurisë “depozitë pranë {\*\*\*}” në*

<sup>18</sup> Shih procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 06.09.2019.

<sup>19</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.09.2019, Kolegji u përcollti palëve në gjykim “Analizën paraprake ekonomiko-financiare për subjektin e rivlerësimit, z. Artur Malaj, dhe personat e lidhur me të, për periudhën 2003-2016”, të përgatitur nga Njësia e Shërbimit Ligjor (28 fletë), shoqëruar nga Aneksi I [Analiza e zërit “Shpenzime për udhëtime jashtë vendit sipas sistemit TIMS” për periudhën 1 janar 2004 – 31 dhjetor 2016] (14 fletë).

*emër të bashkëshortes, deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në DV-2014<sup>20</sup> dhe D-Vetting<sup>21</sup>. [...] Komisioneri Publik, në konsideratë të faktit se Kolegji i Posaçëm i Apelit është organi i vetëm gjyqësor në procesin e rivlerësimit që, në funksion të shqyrtimit të ankimit, zgjidh çështjen në mënyrë përfundimtare, do të vlerësonte kryerjen nga ana e Kolegjit të një analize të plotë dhe përfundimtare financiare, në vlerësim të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, për sa kohë që dhe në vendimin e arsyetuar nuk përmendet pamjaftueshmëria e subjektit të rivlerësimit në mbulimin me burime të ligjshme të pasurive të deklaruara në deklaratën vetting [...]*”.

**29.2** Gjithashtu, gjatë seancës gjyqësore publike të datës 19.07.2019, Komisioneri Publik i pyetur nga vëzhguesi ndërkombëtar i ONM-së, lidhur me shtrirjen e ankimit, është përgjigjur<sup>22</sup>: *Tek ankimi i depozituar një vit më parë, fokusimi i tij ka qenë i gjithë asetit pasuror, pra e gjithë pasuria. Sepse nuk mund të ketë një kontroll, pra nuk mund të bëhet një analizë financiare për një ose për dy asete. Duke kërkuar dhe shtesën, shtesa vjen pikërisht për të mbështetur mendimin e Komisionerit Publik, që qëllimi i tij ka qenë e tërë pasuria dhe jo një ose dy objekte, ose tri objekte, e tërë pasuria. E përsëris që shtesa e ankimit dhe analiza financiare i shkojnë këtij qëllimi që kërkon Komisioneri Publik për të parë në tërësi se sa burime të ligjshme mbulojnë asetet (në numrin shumës), pra të gjithë pasurinë e subjektit të rivlerësimit.*

**29.3** Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për kapërcim të kufijve të shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik, është i pabazuar në prova, për sa kohë Komisioneri Publik në shtesën e ankimit të paraqitur në Kolegji, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.07.2019, ka kërkuar në mënyrë të shprehur nga Kolegji kryerjen e një analize të plotë dhe përfundimtare financiare, pasi nga analiza e kryer prej tij, për periudhën e rivlerësimit 2003-2016, ka rezultuar një diferencë negative në total në vlerën prej 1295.093 lekësh, për vitet e sipërcituara. Analiza është kërkuar për qëllimin e vlerësimit të kriterit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit në tërësinë e tij, si dhe për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, të cilat kanë shtrirje më të gjerë se harku kohor 2007-2011. Përveç kërimit eksplicit në shtesën e ankimit, rezultoi që Komisioneri Publik, nëpërmjet shpjegimit të dhënë para trupit gjykues në seancën e datës 19.07.2019, ka sqaruar se objekti i kërimit të ankimit të tij shtrihet tek “e tërë pasuria” e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur me të.

- 30.** Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për cenim të së drejtës për mbrojtje efektive, si pasojë e mospranimit të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për marrjen e provës me ekspert kontabël të licencuar dhe të regjistruar pranë Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim kryerjen e një analize të re financiare, trupi gjykues thekson se kërkesa e subjektit të rivlerësimit u refuzua bazuar në nenin 49, pika 6, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, pasi marrja e kësaj prove u çmua e panevojshme. Kjo për arsye se një analizë e tillë ishte kryer nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Kolegjit dhe subjekti i rivlerësimit u njoh me të dhe pati mundësi të paraqiste të gjitha kundërshtimet e tij lidhur me këtë dokument, në formën dhe mënyrën që ai konsideronte më të përshtatshme, në kuadër të mbrojtjes efektive të të drejtave të tij, duke përfshirë dhe një akt të një eksperti të tillë, sikundër dhe rezultoi se bëri, duke paraqitur, krahas kundërshtimeve të tij ndaj analizës ekonomiko-financiare, edhe një dokument të titulluar “Akt ekspertimi kontabël - analizë financiare”<sup>23</sup>, i cili u administrua si provë në këtë proces me vendim të ndërmjetëm të trupit

<sup>20</sup> Deklarata e interesave privatë periodikë e vitit 2014.

<sup>21</sup> Deklarata e pasurisë vetting.

<sup>22</sup> Shih faqet 6-7 të procesverbalit të seancës së datës 19.07.2019, përgjigjja e Komisionerit Publik, ora 13:21:54.

<sup>23</sup> Ky akt ekspertimi është përpiluar nga Auditues Ligjore A.C., me nr. {\*\*\*} licence dhe NUIS {\*\*\*} dhe është nënshkruar prej kësaj të fundit dhe subjektit të rivlerësimit.

grykues<sup>24</sup>. Për rrjedhje, pretendimi i subjektit të rivlerësimit për cenim të së drejtës për t'iu mbrojtur në mënyrë efektive, për të kërkuar dhe marrë prova, gjendet i pabazuar.

31. Në lidhje me deklarin e subjektit të rivlerësimit gjatë fazës së bisedimeve përfundimtare rreth mbrojtjes së veçantë të parashikuar në nenin 149 të Kodit Zgjedhor, për gjyqtarin anëtar të Kolegjit Zgjedhor, trupi gjykes, referuar neneve 116, pika 1 dhe 179/b të Kushtetutës, vlerëson se parashikimet e dispozitës së nenit 149 të Kodit Zgjedhor nuk kanë asnjë efekt në ecurinë e procesit të rivlerësimit kalimtar dhe as në vendimmarrjen e institucioneve të rivlerësimit, duke qenë se detyrimi për t'iu nënshtruar procesit të rivlerësimit buron drejtpërdrejt nga Kushtetuta, e cila në mënyrë të shprehur përfshin pa përjashtim, çdo gjyqtar në detyrë dhe ky përcaktim kushtetues ka epërsi ndaj çdo parashikimi tjetër ligjor.

*C. Mbi themelin e pretendimeve sipas shkaqeve të ankimit, lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë*

32. *Lidhur me shkakun e ankimit për deklarin të pasaktë dhe të pamjaftueshëm, lidhur me pasurinë "apartament banimi, me sipërfaqe 106,7 m<sup>2</sup>, me adresë: rruga "{\*\*\*}" (ish-{\*\*\*}), Tiranë", trupi gjykes konstaton sa më poshtë.*
33. Komisioni, në kontrollin dhe vlerësimin e kësaj pasurie gjatë procesit të rivlerësimit, është shprehur në vendim: *Komisioni ka konstatuar se me anë të dokumentit revokim kontrate, të datës 22.07.2005, palët kanë shprehur vullnetin e tyre për zgjidhjen e kontratës së porosisë me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., të datës 31.05.2005, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Pra, kjo kontratë është zgjidhur nga palët po në vitin 2005, rrjedhimisht është i bazuar pretendimi i subjektit se kjo kontratë, sa kohë që u zgjidh, u bë nul, nuk prodhoi efekte juridike, atëherë nuk kishte arsye të deklaronte një kontratë inekzistente në kuptimin ligjor. Në lidhje me pasaktësinë në deklarin, pavarësisht se subjekti nuk ka deklaruar vlerën e apartamentit në vlerë të përcaktuar, por të përafërt, Komisioni vlerëson se kjo ka ardhur nga fakti se kontrata e prenotimit e vitit 2005 u bë nul, pra u zgjidh nga vetë palët, po në vitin 2005, dhe nuk pati mes subjektit dhe shoqërisë ndërtuese marrëveshje të shkruar, por një marrëveshje verbale, të negociueshme, pra me një çmim të përafërt. [...]Nga ana e Komisionit fillimisht janë ngritur dyshime lidhur me aktmarrëveshjen e lidhur më datë 15.05.2008, mes subjektit të rivlerësimit dhe administratorit të shoqërisë "{\*\*\*}" ShPK. Nisur nga provat e reja të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, po ashtu edhe nga arsyetimi ligjor i bërë nga ana jonë, Komisioni vlerëson se kjo marrëveshje duket se është nënshkruar në vijim të një marrëdhënieje komplekse mes subjektit të rivlerësimit dhe investitorit dhe se vërtetësia e saj provohet edhe nga deklarinet e të dyja palëve, si edhe faktit që është konkretizuar nëpërmjet dy kontratave noteriale të shitblerjes [...], duke konkluduar se lidhur me këtë pasuri përputhet deklarin i subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë vetting me dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe nuk duket të ketë dyshime lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie.*
34. Komisioneri Publik kundërshtoi vendimin e Komisionit me pretendimin se ky i fundit, në kontradiktë me provat e administruara në fashikull, ka dalë në konkluzion të gabuar lidhur me aktet "Revokim kontrate" të datës 22.07.2005 dhe "Aktmarrëveshje dhe procesverbal i marrjes në dorëzim" të datës 15.05.2008, duke i pranuar ato si provë dhe për rrjedhje, duke justifikuar mospërputhjet e konstatuara midis deklarinëve të subjektit të rivlerësimit në deklaratën periodike të vitit 2005 dhe në deklaratën e pasurisë vetting, lidhur me vlerën dhe burimin e krijimit të apartamentit të banimit. Gjithashtu, Komisioneri Publik pretendoi se subjekti i rivlerësimit dhe

<sup>24</sup> Shih procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 03.10.2019.

personi i lidhur me të nuk kanë pasur burime të ligjshme të mjaftueshme për të mbuluar pagesën e këstit të parë për prenotimin e apartamentit, sipas kontratës së sipërmarrjes së datës 31.05.2005, duke qenë se referuar deklaratave të interesave privatë periodikë të viteve 2003, 2004 deri në maj 2005, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur kursime të mjaftueshme në formën e likuiditetit në gjendje *cash* për të mbuluar këstin e parë, në vlerën e 15.130 euro, i cili referuar parashikimeve kontraktuale është paguar në datën e lidhjes së kontratës mes palëve.

35. Pretendimin për konkluzion të gabuar të Komisionit, lidhur me vlerësimin e dy akteve të sipërcituara, Komisioneri Publik e bazoi në argumentet e mëposhtme.

(i) Shkresa private “revokim kontrate” nuk është akt zyrtar në kuptim të nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, ajo do duhej të ishte në formën e aktit noterial dhe të dorëzohej pranë ILDKPKI-së me qëllim që të merrej si provë në këtë proces dhe të kishte efekt në vlerësimin e rrethanave të kësaj pasurie.

(ii) Pretendimi i subjektit të rivlerësimit për revokimin e kontratës së sipërmarrjes të datës 31.05.2005, bie në kundërshtim me deklarinimin periodik të vitit 2005 të subjektit pranë ILDKPKI-së, si dhe me deklarinimin e palëve në procesverbalin e marrjes në dorëzim të apartamentit, mbajtur më datë 15.5.2008.

(iii) Shkresa private “Aktmarrëveshje dhe procesverbal i marrjes në dorëzim”, e datës 15.05.2008, nuk përmbush kushtet e neneve 253 dhe 257 të Kodit të Procedurës Civile. Kjo shkresë duhet të ishte në formën e aktit noterial, ndaj dhe nuk duhet të ishte vlerësuar si provë nga Komisioni, lidhur me situatën faktike të përshkruar në të.

(iv) Shkresa në fjalë, sipas Komisionerit Publik, përmban edhe një sërë të dhënash të tjera të pavërteta, siç janë ato lidhur me sipërfaqen e apartamentit të banimit, si dhe pretendimi për dakordësi për prenotim të garazhit të mbyllur me sip 16 m<sup>2</sup>.

(v) Të dyja dokumentet shkrese të sipërcituara përmbajnë deklarime të pavërteta me qëllim përkatësisht, paraqitjen fiktive të realizimit të pagesave dhe përcaktimin e çmimit të apartamentit të banimit.

36. Komisioneri Publik ngriti edhe pretendimin se çmimi i shitjes në kontratën noteriale të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.10.2008, para noterës N.K., është përcaktuar në shkelje të detyrimit të vendosur sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë nr. 5, datë 18.01.2008, “Mbi tatimin për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme”, sipas të cilit, çmimi i shitjes për metra katrorë nuk mund të jetë më i ulët se çmimi i përcaktuar në shtojcën e këtij udhëzimi.

37. Lidhur me këtë shkak të ankimit, subjekti i rivlerësimit parashit se pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me apartamentin e banimit janë të pabazuara në provat e administruara dhe të shqyrtuara nga Komisioni, si dhe në ato të dorëzuara prej tij në Komision, duke prapësuar sa vijon.

(i) Mospërputhjet në deklarime lidhur me vlerën e pasurisë vijnë si rrjedhojë e fakteve të papranuara nga Komisioneri Publik se kontrata e sipërmarrjes e datës 31.05.2005 është zgjidhur nga palët, është bërë nul dhe nuk është ekzekutuar asnjëherë, dhe se sipas aktmarrëveshjes së vitit 2008, palët kanë rënë dakord për ulje të çmimit, si pasojë e dorëzimit të apartamentit nga sipërmarrësi me vonesë, mospërfundimit të një sërë punimesh të brendshme, si dhe mospërputhjes së sipërfaqes faktike të apartamentit me atë të prenotuar.

(ii) Sa i takon formës së aktit të revokimit të kontratës, subjekti i rivlerësimit argumentoi se pretendimi i Komisionerit Publik se ky akt, me qëllim që të përbënte provë për Komisionin, duhet të ishte akt noterial, është pretendim i pabazuar në ligj, duke qenë se forma e veprimit juridik është kusht për vlefshmërinë e tij, vetëm atëherë kur kërkohet shprehimisht nga ligji, dhe se në rastin e kontratës së sipërmarrjes, rrjedhimisht edhe për revokimin e saj, ligji nuk e parashikon formën si element, mosrespektimi i të cilit sjell pavlefshmërinë e veprimit juridik. Për më tepër, subjekti pretendoi se përmbajtja e aktit të revokimit është përsëritur edhe në deklaratën noteriale të administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK të datës 16.07.2018, që sipas subjektit të rivlerësimit përbën akt zyrtar, sipas nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile. Për rrjedhojë, subjekti pretendoi se referuar neneve 259 dhe 263 të Kodit të Procedurës Civile, shkresa e thjeshtë “revokim kontrate”, përbën provë të plotë lidhur me deklaratimet e sipërmarrësit, duke qenë se ai i ka konfirmuar ato me anë të deklaratës noteriale të datës 16.07.2018 dhe për sa kohë nuk është pretenduar nga ana e Komisionerit Publik falsiteti i kësaj shkrese.

(iii) Revokimi i kontratës së sipërmarrjes dhe aktmarrëveshja e vitit 2008 janë akte juridike të rregullta, të nënshkuara me vullnetin e palëve dhe, si të tilla, janë akte të vlefshme. Kontrata e sipërmarrjes (e zgjidhur po në vitin 2005) është lidhur para noterit dhe nuk është marrëveshje e fshehtë mes palëve, por ajo nuk është deklaruar për shkak se është bërë nul nga vetë palët nënshkruese. Sa i takon pretendimit të Komisionerit Publik për deklarimin e saj pranë ILDKPKI-së, subjekti deklaroi se ky është pretendim i pabazuar në ligj, për sa kohë ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar dhe ligji nr. 9367, datë 07.04.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, nuk parashikojnë detyrimin për deklarim të veprimeve juridike, të cilat nuk kanë sjellë shtim apo pakësim të pasurisë së subjekteve deklaruese brenda vitit.

(iv) Pretendimi i Komisionerit Publik lidhur me përcaktimin e çmimit të shitjes në kontratën e shitblerjes së vitit 2008, në kundërshtim me udhëzimin e përbashkët të ministrit të Financave dhe ministrit të Drejtësisë nr. 5, datë 18.01.2008, “Mbi tatimin për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme” është i pabazuar në ligj, pasi ky udhëzim është detyruar për organet shtetërore për efekt të llogaritjes së tatimit dhe jo për palët kontraktore në një kontratë shitblerjeje. Subjekti i rivlerësimit parashtrroi gjithashtu se ky pretendim i Komisionerit Publik cenon lirinë kontraktore të palëve të sanksionuar në nenin 660 të Kodit Civil, si dhe bie ndesh me parimin e hierarkisë së akteve ligjore, të përcaktuar shprehimisht në nenin 116 të Kushtetutës.

38. Subjekti i rivlerësimit pretendoi qëndrim me dy standarde nga ana e Komisionerit Publik lidhur me pretendimet e tij në drejtim të formës së aktit ndryshues (aktit të revokimit), duke qenë se, sipas subjektit, Komisioneri Publik ka mbajtur qëndrim të ndryshëm ndaj vendimeve të ngjashme të Komisionit lidhur me këtë çështje, duke mos i ankumuar ato.
39. Gjithashtu, sa i takon pretendimit të Komisionerit Publik për pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme për të justifikuar pagesat e kryera për prenotimin e apartamentit në vitin 2005, subjekti i rivlerësimit e kundërshtoi si të pabazuar në prova këtë pretendim, me justifikimin se detyrimet që rridhnin nga kontrata e sipërmarrjes e datës 31.05.2005, janë bërë *nul*, dhe sipas tij, asnjëri prej tyre (përfshirë pagesën e kështit të parë) nuk është përmbushur prej subjektit të rivlerësimit.
40. Në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të ngritura nga palët lidhur këtë shkak të ankimit në paragrafët 35 dhe 37 më sipër në vendim, trupi gjykues konstatoi fillimisht se ai lidhet me të dyja elementet objekt kontrolli të institucioneve të rivlerësimit, në kuptim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016, konkretisht: (i) vlerësimit të saktësisë së deklarimit

të subjektit lidhur me pasurinë “apartament banimi”; dhe (ii) vlerësimin të mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie (lidhur me pagesën e kështit të parë sipas përcaktimit në kontratën e sipërmarrjes, në vlerën 15.130 euro).

41. Duke u bazuar në pretendimet e Komisionerit Publik lidhur me këtë shkak të ankimit, si dhe në mënyrën e parashtrimit të kundërshtimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me to, vihet re se pretendimi për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për krijimin e apartamentit të banimit, lidhet ngushtësisht me rezultatin e vlerësimit të elementit të parë të kontrollit, atij të saktësisë së deklaramit lidhur me këtë pasuri. Në këtë kuptim, trupi gjykues vlerësoi se, sa i takon vlerësimit të saktësisë së deklaramit, nevojitet të trajtohen dy momente:

(i) A provohet nga dokumentacioni i administruar në dosjen gjyqësore ekzistenca e mospërputhjeve në deklaramin e subjektit të rivlerësimit, sipas deklaratës së pasurisë *vetting* dhe deklaratave periodike, ndër vite, lidhur me këtë pasuri të paluajtshme, sa u takon elementeve thelbësore që identifikojnë pasurinë objekt shqyrtimi në pronësi të subjektit të rivlerësimit, ku për efekt të këtij procesi evidentojmë origjinën e pasurisë, vlerën dhe burimin e krijimit të saj?

(ii) Nëse po, a justifikohen këto mospërputhje nga aktet e administruara në fashikullin e gjykimit, duke mos u vlerësuar si deklaramin i pasaktë në kuptim të nenit D të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të ligjit nr. 84/2016, apo ato nuk mund të justifikohen dhe provojnë, si pasojë, ekzistencën e të paktën një prej rasteve të parashikuara në nenin 33, pika 5, paragrafët nga “b” – “d” të ligjit nr. 84/2016<sup>25</sup>, duke e bërë deklaramin e subjektit të pamjaftueshëm në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016?

42. Nga shqyrtimi i akteve, sa i takon ekzistencës apo jo të mospërputhjeve në deklaramin e subjektit të rivlerësimit lidhur me origjinën, vlerën dhe burimin e krijimit të pasurisë “apartament banimi”, trupi gjykues konstatoi në mënyrë të përmbledhur sa vijon.

◦ Në deklaratën e pasurisë *vetting*, deklarohe:

(i) origjina e pasurisë: “prenotuar në vitin 2005 për një çmim rreth 55.000 euro së bashku me një garazh, ndërkohë në vitin 2008 çmimi përfundimtar i apartamentit u la 5.000.000 lekë sipas aktmarrëveshjes dhe procesverbalit të marrjes në dorëzim, datë 15.05.2008, për shkak të disa mangësive dhe vonesave nga shoqëria ndërtuese”;

(ii) vlera e pasurisë: “5.000.000 lekë”;

(iii) burimi i krijimit: “kredi me vlerën 5.000.000 lekë në Bankën {\*\*\*}”.

◦ Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2005, deklarohe:

(i) origjina e pasurisë: “kontratë sipërmarrjeje me firmën “{\*\*\*}” ShPK, datë 31.05.2005”;

(ii) vlera e pasurisë: “rreth 55.000 euro (nga e cila vlera prej 5.000.000 lekësh, e paguar sipas kredisë, pjesa tjetër në përfundim);

(iii) burimi i krijimit: “kredia për pjesën e shlyer”.

<sup>25</sup> Neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon:

5. Në përfundimin të kontrollit, Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, sipas rastit, konstaton se:

a) deklaramin është i saktë në përputhje me ligjin, me burimet e ligjshme financiare dhe që nuk gjendet në situatë konfliktit interesi;

b) ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;

c) është kryer fshehje e pasurisë;

ç) është kryer deklaramin i rremë;

d) subjekti gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

◦ Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, evidentohet në cilësinë e aktit juridik që ka shërbyer, sipas subjektit, për krijimin e kësaj pasurie, kontrata noteriale e shitblerjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.10.2008, e lidhur para noteres së dhomës së noterisë Tiranë, N.K., kushtet e së cilës lidhur me çmimin e shitjes (vlerën e pasurisë) janë përcaktuar sipas “Aktmarrëveshjes dhe procesverbalit të marrjes në dorëzim”, datë 15.05.2008. Sipas kontratës së shitblerjes së sipërcituar, vlera e pasurisë është përcaktuar 5000000 lekë.

◦ Referuar pyetësorëve të dërguar nga ana e Komisionit, sa i takon origjinës së pasurisë, subjekti është përgjigjur: “Nuk disponoj kontratë prenotimi me shoqërinë për shkak se kalimi i parave për porositjen e shtëpisë është bërë drejtpërdrejt me bankë, {\*\*\*} Bank, duke u përcaktuar edhe qëllimi [...]. Dua të theksoj se me shoqërinë kishim rënë dakord verbalisht (me gojë) që të blija një apartament rreth 117 m<sup>2</sup> dhe garazh me sipërfaqe 16 m<sup>2</sup> të mbyllur, për një vlerë në total rreth 55 mijë euro”. Ndërkohë që në vijim Komisioni, pasi ka administruar dosjen e kredisë nga Banka {\*\*\*} është vënë në dijeni të kontratës noteriale të sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 31.05.2005, të lidhur para noteres S.M., mes shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit, dhe subjektit të rivlerësimit Artur Malaj, në cilësinë e porositësit të një apartamenti banimi me sipërfaqe 117,5 m<sup>2</sup> që do ndërtohej në rrugën “{\*\*\*}”. Referuar kësaj kontrate, vlera e ambientit të porositur, e përcaktuar në nenin 4 të saj, është 61.100 euro, kurse mënyra e pagesës në katër këste<sup>26</sup>, ndër to i pari në vlerën e 15.130 eurove është deklaruar i paguar në datën e lidhjes së kontratës.

◦ Në shpjegimet e tij ndaj rezultateve të hetimit të dorëzuara në Komision në datën 20.07.2018, subjekti i rivlerësimit përmend për herë të parë kontratën e sipërcituar të sipërmarrjes dhe shpjegon lidhur me të: *Kontrata e sipërmarrjes e datës 31.05.2005 është nul, nuk ka prodhuar asnjëherë efekt, si e tillë as është deklaruar prej meje dhe unë realisht as e kam disponuar fizikisht në vitin 2006, në kohën e deklaramit të pasurisë, një kopje të kësaj kontrate. Kjo marrëveshje është bërë nul nga vetë shoqëria ndërtuese po në vitin 2005, pasi as prej meje<sup>27</sup>, as prej saj<sup>28</sup> nuk janë përmbushur ato që shkruheshin në kontratë.* Për të provuar sa deklaron, subjekti ka paraqitur në cilësinë e provës një shkresë “Revokim kontrate”, datë 22.07.2005<sup>29</sup>, ku në cilësinë e deklaruesve paraqiten subjekti i rivlerësimit dhe z. G.Ç. (administratori i shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, një deklaratë noteriale të z. Ç., datë 16.07.2018, si dhe kontratën e shitblerjes së apartamentit të një fqinje të tij.

43. Në vlerësim të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se mes deklaratës së pasurisë *vetting* dhe asaj periodike të vitit 2005, por edhe mes deklaramëve të subjektit të rivlerësimit në këto deklarata, deklaramëve të tij në Komision dhe akteve të administruara në fashikull gjatë hetimit të

<sup>26</sup> Modalitet e shlyerjes së çmimit sipas nenit 4 të kontratës së sipërmarrjes:

Kësti i parë – 15.130 euro, u pagua sot, me lidhjen e kësaj kontrate.

Kësti i dytë – 15.000 euro, do të paguhet më datë 15 korrik 2005.

Kësti i tretë – 20.000 euro, do të paguhet në tetor 2005.

Kësti i fundit – diferenca prej 10.970 eurosh, do të paguhet në momentin kur porositësi fillon të përdorë ambientin e kontraktuar (bën kontratën e shitjes).

<sup>27</sup> Në vijim, në shpjegimet e tij sqaron se pretendimet e shoqërisë sipërmarrëse lidheshin me mospagesën e kësteve sipas kontratës së prenotimit të datës 31.05.2005 (shih faqen 1 të shpjegimeve të subjektit, lidhur me rezultatet e hetimit administrativ).

<sup>28</sup> Në vijim, në shpjegimet e tij, subjekti sqaron se pretendimet e tij ndaj shoqërisë ndërtuese që duket se kanë çuar palët në revokimin e kësaj kontrate, lidheshin me sipërfaqen e apartamentit të prenotuar, për të cilën subjekti pretendon se ka qenë në lajthim lidhur me sipërfaqen e brendshme të apartamentit.

<sup>29</sup> Shkresa është paraqitur e njësuar sipas vërtetimit përkatës të noteres M.J., me nr. {\*\*\*} rep., datë 20.07.2018.



Komisionit, të cilat lidhen me pasurinë në fjalë, ekzistojnë mospërputhje<sup>30</sup> në të dhënat e deklaruara lidhur me origjinën, çmimin dhe burimin e krijimit të apartamentit të banimit.

44. Në analizë të fakteve të sipërcituara, në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të Komisionerit Publik lidhur me këtë pasuri, si dhe në trajtim të çështjes së parashtruar në paragrafin 41 (ii) më sipër, trupi gjykues çmoi të nevojshme marrjen në analizë të dy akteve shkresore të dorëzuara nga subjekti në cilësinë e provës, njëri prej tyre si dokumentacion justifikues bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting*, në përputhje me nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 (“Aktmarrëveshje dhe procesverbal i marrjes në dorëzim”), dhe tjetri dorëzuar pranë Komisionit, bashkëlidhur kundërshtimeve të subjektit ndaj rezultateve të hetimit, pas kalimit të barrës së provës lidhur me rezultatet për apartamentin e banimit (“Revokim kontrate”).
45. Nga shqyrtimi i aktit “Revokim kontrate”, sa i takon elementit të formës që ai duhet të ketë, si një akt juridik, i cili synon të ndryshojë një vullnet të shprehur tashmë prej palëve lidhur me prenotimin e një apartamenti banimi nëpërmjet kontratës noteriale të sipërmarrjes, duke pasur parasysh që për lidhjen e kësaj kontrate Kodi Civil nuk kërkon në mënyrë të posaçme formë të caktuar, trupi gjykues, referuar dispozitave të Kodit Civil, neneve 79, 80, 81, 83, 659, 663 dhe 850, arriti në përfundimin se forma e aktit të revokimit (shkresë e thjeshtë), qartazi e ndryshme nga ajo e kontratës së sipërmarrjes së datës 31.05.2005 (akt noterial), nuk cenon vlefshmërinë e tij, për shkak të formës jo të njëjtë të shprehjes së vullneteve të palëve në dy momente të ndryshme kohore. Në vijim të sa më sipër, në aspektin formal, shkresa “Revokim kontrate” përmbush kriteret e vlefshmërisë dhe ajo *prima facie* vlerësohet se ka fuqinë provuese të një shkrese të thjeshtë (private), në kuptim të neneve 246, 251, 258 dhe 259 të Kodit të Procedurës Civile. Për rrjedhojë, në kushtet që referuar legjislacionit në fuqi, akti i revokimit të kontratës është një akt i vlefshëm, sa i takon formës me anë të së cilës është materializuar vullneti i palëve, pretendimi i Komisionerit Publik që ky akt për të përbërë provë do duhet të kishte formën e aktit noterial, vlerësohet nga trupi gjykues se nuk qëndron.
46. Pavarësisht sa më sipër, në kuadër të shqyrtimit të shkakut të ankimit të ngritur nga Komisioneri Publik, sipas të cilit ndodhemi para një rasti të një deklarimi të pasaktë të pasurisë, duke marrë parasysh ekzistencën e mospërputhjeve të dukshme në deklarime dhe informacioneve kontradiktore të subjektit të rivlerësimit gjatë procesit në Komision, si pasojë e të cilave ngrihen dyshime nga Komisioneri Publik për deklarime fiktive, trupi gjykues çmoi të nevojshme marrjen në analizë të vlerës provuese të aktit “Revokim kontrate”, në kuadër të procesit të rivlerësimit dhe jo në kuptim të vlerës provuese të tij për marrëdhënien midis palëve nënshkruese. Gjithashtu, forma e tij, e shkresës së thjeshtë (private), krahasuar me aktin noterial që merr datë të saktë dhe regjistrohet në regjistrat publikë, kopjet e të cilit arkivohen e administrohen nga noteri publik, mbart me vete dyshimin që akti të jetë krijuar prej palëve në një datë të mëvonshme nga sa pretendohet sipas shkresës.
47. Në kuadër të sa më sipër, trupi gjykues konstatoi se marrëdhënia juridike e sipërmarrjes e krijuar mes palëve në vitin 2005, pavarësisht rrethanave në të cilat është zhvilluar, është konkretizuar me ndërtimin nga pala sipërmarrëse dhe kalimin prej saj në vijim, të pronësisë së apartamentit të porositur, subjektit të rivlerësimit në vitin 2008, pasi ky i fundit kishte shlyer edhe çmimin përkatës, duke përmbushur në këtë mënyrë edhe objektin e kontratës së sipërmarrjes. Si pasojë e sa më sipër, palët e kësaj kontrate të lidhur më datë 31.05.2005, nuk rezultojnë të jenë në një marrëdhënie të ndërvarur të drejtash dhe detyrimesh lidhur me pasurinë objekt gjykimi, që prej tetorit të vitit 2008, pas kalimit të pronësisë së apartamentit nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK te subjekti

<sup>30</sup> Shih konstatimet në paragrafin 42 më sipër në vendim.

i rivlerësimit. Për rrjedhojë, në kuadër të kësaj analize *post-factum*, trupi gjykues vlerëson se deklarata noteriale e z. G.Ç., në cilësinë e palës sipërmarrëse, dhënë para noterit publik E.H., më datë 16.07.2018<sup>31</sup>, për një ngjarje të pretenduar se ka ndodhur më datë 22.07.2005, nuk arrin ta bindë trupin gjykues mbi ekzistencën e dakordësisë së palëve për të revokuar kontratën e sipërmarrjes të lidhur më datë 31.05.2005, dhe si e tillë ajo nuk vlerësohet si pranim i deklarimeve të sipërmarrësit në shkresën e thjeshtë “Revokim kontrate”. Për rrjedhojë, referuar dispozitave të Kodit të Procedurës Civile<sup>32</sup>, lidhur me fuqinë provuese të shkresave të thjeshta, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se shkresa e thjeshtë “Revokim kontrate” përbën provë të plotë të deklarimeve të sipërmarrësit, duke qenë se ai i ka konfirmuar ato me anë të deklaratës noteriale të datës 16.07.2018, nuk gjendet i bazuar.

48. Në vijim të shqyrtimit të këtij akti (revokimit të pretenduar të kontratës së sipërmarrjes së lidhur më datë 31.05.2005), i cili nuk është deklaruar asnjëherë nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI dhe as është dorëzuar pranë këtij institucioni bashkëlidhur deklaratës së pasurisë *vetting* së bashku me aktet e tjera justifikuese, në kuadër të parashikimeve të nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, sikundër dhe gjurmë të këtij akti nuk u gjetën as nga hetimi administrativ i Komisionit pranë institucioneve të tjera, me të cilat subjekti kishte krijuar marrëdhënie juridiko-civile, me objekt pasurinë në fjalë, deri në momentin kur ai paraqitet nga subjekti i rivlerësimit, bashkëlidhur kundërshtimeve të tij ndaj rezultateve të hetimit të Komisionit, u çmua i nevojshëm nga trupi gjykues orientimi drejt një analize më të hollësishme, e cila synonte verifikimin e ekzistencës apo jo të vullnetit të pretenduar të palëve, për të zgjidhur marrëdhënien e krijuar me kontratën noteriale të sipërmarrjes datë 31.05.2005.
49. Për efekt të kësaj analize, u morën në shqyrtim nga trupi gjykues dhe u vlerësuan rrethanat në të cilat kanë ndodhur faktet lidhur me krijimin e kësaj pasurie, qëllimi i deklaruar prej palëve në aktin e revokimit të kontratës së sipërmarrjes, ku në këtë kuadër u analizua sjellja e palëve në raport me këtë akt, para dhe pas përfundimit të aktit të pretenduar të revokimit, si dhe ndërveprimi i subjektit të rivlerësimit me palë të treta gjatë kësaj periudhe kohore, për çështje të lidhura me pasurinë objekt shqyrtimi, nga ku trupi gjykues vëren sa më poshtë.

(i) Në aktin shkresor “Revokim kontrate” të datës 22.07.2005, palët duke iu referuar kontratës së sipërmarrjes, të lidhur më datë 31.05.2005, kanë deklaruar: *Mbas nënshkrimit të kësaj kontrate, porositi nuk pagoi këstet brenda afateve të përcaktuara në këtë kontratë me pretendimin se nuk i është disbursuar kredia që do të merrte pranë {\*\*\*} Bank, ndërkohë që referuar dosjes së kredisë së përcjellë gjatë procedurës së hetimit administrativ nga Bankën {\*\*\*}, aktet<sup>33</sup> për plotësimin e*

<sup>31</sup> Me nr. {\*\*\*} rep. dhe nr. {\*\*\*} kol.

<sup>32</sup> Neni 259 i Kodit të Procedurës Civile parashikon:

“Shkresa e thjeshtë e nënshkruar nga personi që e ka lëshuar, përbën provë të plotë se deklarimet që përmban janë të atij që e ka nënshkruar, në rast se personi kundër të cilit paraqitet shkresa pranon se është nënshkruar prej tij”.

Neni 262 i të njëjtit Kod parashikon:

“Shkresa private përbën provë në favor të përpiluesit vetëm në qoftë se atë e paraqet pala kundërshtare ose në qoftë se bëhet fjalë për librat që përmenden në nenin 260”.

<sup>33</sup> Referuar Aneksit I/B, germa “b” e marrëveshjes së lidhur midis Bankës {\*\*\*} dhe Ministrisë së Financave “Mbi kreditimin nga RBAL të nevojave për strehim të funksionarëve politikë dhe të nëpunësve civilë të administratës së lartë”, dokumentet që kërkoheshin për blerjen e një apartamenti në ndërtim përpara aprovimit të kredisë ishin:

- marrëveshje e sipërmarrjes të lidhur midis aplikantit dhe kompanisë së ndërtimit;
- kopje e lejes së ndërtimit;
- kopje e certifikatës së pronësisë ku bëhej ndërtimi;
- aktin noterial midis kompanisë së ndërtimit dhe pronarëve të tokës;
- certifikatë pronësie e pronës që do të lihet peng për kohësisht në favor të bankës dhe dokumentet e nevojshme që vërtetojnë origjinën e pronësisë;

praktikës së kredisë rezultojnë të jenë dorëzuar nga ana e subjektit të rivlerësimit në intervalin kohor 25.07.2005 - 29.07.2005, dy muaj pas datës 31.05.2005, në të cilën është lidhur kontrata e sipërmarrjes, madje edhe mbas datës 22.07.2005, në të cilën ajo pretendohet të jetë revokuar. Për më tepër, pasuria e paluajtshme e cila do të hipotekohej në favor të institucionit bankar, për të siguruar kredinë në cilësinë e kolateralit, është blerë nga z. A.G. më datë 29.07.2005, rreth 2 muaj pas lidhjes së kontratës së sipërmarrjes mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë sipërmarrëse. Për gjithë sa më sipër, trupi gjykues krijoi bindjen se në datën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, 31.05.2005, vullneti i subjektit të rivlerësimit në arritjen e dakordësisë me palën sipërmarrëse mbi mënyrën e pagesës së çmimit të sipërmarrjes, nuk kishte mundësi objektive të diktohej nga pritshmëritë imediate të dhënies së një kredie pranë Bankës {\*\*\*}, për sa kohë në atë datë subjekti ende nuk kishte formalizuar aplikimin e tij për kredi pranë së njëjtës bankë, mbi gjithçka ende nuk kishte siguruar ekzistencën e kolateralit që do të garantonte këtë kredi.

(ii) Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në shpjegimet e tij, lidhur me rezultatet e hetimit të Komisionit, se kontrata e sipërmarrjes u bë *nul* me vullnetin e palëve, pasi ajo nuk kishte prodhuar asnjë efekt. Madje gjatë seancës dëgjimore në Komision, subjekti pretendoi se pavarësisht se para noterit palët kanë deklaruar pagesën e kështit të parë, ky fakt nuk ishte i vërtetë dhe deklarimi është bërë në mirëbesim, për shkak të pritshmërisë së subjektit për disbursimin e kredisë, duke qenë se ishte në proces të marrjes së saj, pretendim ky që në vijim të sa më sipër gjendet i pabazuar në prova.

(iii) Subjekti i rivlerësimit pretendoi gjithashtu se qëllimi i palëve ishte tërheqja nga kontrata e sipërmarrjes për shkak se nuk kishte prodhuar asnjë efekt të synuar dhe, me nënshkrimin e aktit të revokimit, kontrata e sipërmarrjes juridikisht nuk ekzistonte më. Për pasojë, sipas tij, palët nuk i lidhte më asnjë e drejtë apo detyrim sipas përcaktimeve të kontratës. Ndërkohë, nga aktet e fashikullit gjyqësor, rezultoi se kontrata e sipërmarrjes është dorëzuar në Bankën {\*\*\*} në kuadër të aplikimit për kredi të butë, jo më parë se data 28.07.2005, rreth 1 javë pas aktit të pretenduar të revokimit. Ky fakt konfirmohet nga vula nr. {\*\*\*} rep., datë 28.07.2005, që ndodhet në trupin e kontratës së sipërmarrjes, për njësimin e kopjes së saj me origjinalin, pranë noteres A.M., çka krijoi bindjen te trupi gjykues se minimalisht në këtë datë (28.07.2005) nuk provohet që qëllimi i përpilimit të aktit të revokimit të ketë qenë tërheqja e palëve (më së paku e subjektit të rivlerësimit) nga detyrimet dhe të drejtat e krijuara me kontratën e sipërmarrjes.

(iv) Në kuadër të analizës së mësipërme, trupi gjykues mban në konsideratë edhe faktin që në datën 05.12.2006, subjekti i rivlerësimit ka bërë plotësimin e deklarimit të kryer pranë ILDKPKI-së për vitin 2005 dhe në faqen 3 të tij, në rubrikën “Deklarimi i interesave private, pasuritë e paluajtshme, pasuritë e luajtshme” ka deklaruar shprehimisht: *Prenotim apartamenti me sipërfaqe rreth 102 m<sup>2</sup>, me kontratë sipërmarrjeje me firmën “{\*\*\*}” ShPK, datë 31.05.2005 [...]*. Në vlerësim të trupit gjykues, deklarimi i mësipërm i subjektit të rivlerësimit pranë ILDKPKI-së, më datë 05.12.2006 hedh poshtë pretendimin fillestar të tij, se me palën sipërmarrëse ka pasur që në krye të herës një marrëveshje verbale, pasi rezultoi e provuar nga dokumentacioni i përcjellë nga Banka {\*\*\*} se mes të njëjtave palë, në datën e deklaruar pranë ILDKPKI-së, 31.05.2005, ishte lidhur një kontratë noteriale sipërmarrjeje. Gjithashtu, i pabazuar rezulton në vlerësimin e trupit gjykues edhe pretendimi tjetër i subjektit të rivlerësimit, se në vijim të revokimit më datë 22.07.2005 të kontratës noteriale të sipërmarrjes, palët kanë lidhur një marrëveshje verbale për prenotimin e apartamentit. Pra, nëse ky pretendim do të ishte i vërtetë, logjikisht marrëveshja e lidhur mes palëve pas revokimit të kontratës së sipërmarrjes më datë 22.07.2005, duhet të korrespondonte me

marrëveshjen e deklaruar pranë ILDKPKI-së, në datën 05.12.2006, si më sipërcituar. Në një interpretim logjik të fakteve, kjo nuk mund të ndodhë, për sa kohë (i) në datën 31.05.2005, deklaruar në ILDKPKI si data e kontratës së sipërmarrjes, e lidhur mes subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, rezulton të jetë lidhur një kontratë noteriale dhe jo verbale e sipërmarrjes; sikundër dhe (ii) nëse pranë ILDKPKI-së subjekti do të kishte deklaruar kontratën verbale, të pretenduar të lidhur mes palëve pas revokimit të kontratës noteriale, ajo do duhet të mbante datë të njëjtë ose të mëvonshme nga data 22.07.2005, dhe jo datën 31.05.2005, atë të kontratës që pretendohet se u revokua si kontratë *nul*.

(v) Referuar përshkrimit të dakordësisë së palëve në “Aktmarrëveshjen dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim” lidhur me sipërfaqen e apartamentit (117,5m<sup>2</sup>), afatin e dorëzimit (maj 2006<sup>34</sup>), referimit të palëve “në negocimin dhe prenotimin e apartamentit në maj të vitit 2005”, sikundër dhe krahasimit të përshkrimit të apartamentit sipas kontratës së shitjes (apartamenti {\*\*\*}, kati {\*\*\*}, sipërfaqe 106,7 m<sup>2</sup>) dhe asaj të kontratës së sipërmarrjes (apartament me sipërfaqe 117,5 m<sup>2</sup>, në katin e {\*\*\*} të banimit, kuota 13.26, i përbërë nga një kuzhinë, tri dhoma gjumi, dy banjo dhe ballkone<sup>35</sup>, me sipërfaqe të përbashkëta sipas neneve 209 dhe 210 të Kodit Civil), konstatohet se, pavarësisht mungesës në referimin të kontratës së sipërmarrjes sipas ekstremiteteve të saj, përmbajtja e dakordësisë fillestare lidhur me të dhënat e apartamentit të porositur sipas përshkrimit në “Aktmarrëveshjen dhe procesverbalin e marrjes në dorëzim” të drejton në kontratën e sipërmarrjes së lidhur para noterit S.M., më datë 31.05.2005 dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues e vlerëson këtë fakt si tregues lidhur me vullnetin real të palëve, i cili as në atë moment kohor, konkretisht më datë 15.05.2008, nuk arrihet të provohet që të ketë qenë ai për revokimin e kontratës noteriale të sipërmarrjes.

50. Në përfundim të sa më sipër, lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për konkluzion të gabuar të Komisionit lidhur me vlerësimin e aktit “Revokim kontrate”, trupi gjykues arrin në përfundimin se, për sa kohë nuk u arrit të provohet se vullneti i palëve për revokimin e kontratës noteriale të sipërmarrjes ka ekzistuar vërtet dhe palët e kanë shprehur dhe realizuar këtë vullnet, kontrata e sipërmarrjes, e lidhur mes tyre më datë 31.05.2005, para noterit publik, në kuptim të nenit 690 të Kodit Civil dhe nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, ka forcën e ligjit për palët dhe përbën provë të plotë të deklarimeve të tyre para noterit, për faktet që kanë ngjarë në prani të tij. Për rrjedhojë, kontrata e sipërcituar e sipërmarrjes i ka sjellë efektet e saj, më së paku sa i takon pagimit të këstit të parë të çmimit për prenotimin e apartamentit, në vlerën prej 15.130 eurosh. Në arritjen e këtij përfundimi, trupi gjykues mbajti në konsideratë edhe parashikimet e neneve 696 dhe 698 të Kodit Civil, sipas të cilave e drejta e palëve për t’u tërhequr nga kontrata mund të ushtrohet për sa kohë kontrata nuk ka filluar të zbatohet, në rast të kundërt ajo mundet vetëm të zgjidhet, sipas rregullimeve përkatëse të Kodit Civil.
51. Në lidhje me pretendimin e Komisionerit Publik lidhur me formën e aktit “Aktmarrëveshje dhe procesverbal i marrjes në dorëzim” dhe efektet e saj në vlefshmërinë e tij, trupi gjykues mban të njëjtin qëndrim si në paragrafin 45 më sipër në vendim.

<sup>34</sup> Referuar nenit 5 të kontratës së sipërmarrjes, “Si datë e përfundimit të ambientit të kontraktuar, do të jetë data kur sipërmarrësi e gjykon të përfunduar, brenda periudhës njëvjeçare nga dita e lidhjes së kësaj kontrate”, ku afati i bie të jetë data 31.05.2006.

<sup>35</sup> Përshkrimi në fjalë përputhet me planimetrinë e apartamentit sipas kontratës së shitblerjes, i cili paraqet një apartament me 3 dhoma gjumi, kuzhinë, dy banjo dhe ballkone dhe sipërfaqja totale e ndërimit (përfshirë dhe sipërfaqet e përbashkëta, sipas përcaktimit në Kodin Civil) është 117,5 m<sup>2</sup>.

52. Sa i takon analizës së përmbajtjes së këtij akti, në drejtim të qëllimit të deklaruar prej palëve dhe sjelljes së tyre në raport me pasurinë objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstatoi fillimisht se, në tekstin e aktmarrëveshjes së sipërcituar, pretendimet që parashtrajnë palët dhe që sipas tyre kanë shërbyer si shkak për caktimin e një çmimi të ndryshëm nga ai i rënë dakord fillimisht, deklarohen:
- a) sipërfaqja e apartamentit, e cila është dakordësuar fillimisht 117,5 m<sup>2</sup>, por në fakt, sipas palëve, është 106,7 m<sup>2</sup>;
  - b) sipërfaqja e garazhit, e cila pretendohet të jetë dakordësuar fillimisht 16 m<sup>2</sup> dhe i mbyllur, por në fakt është pa mure rrethuese dhe pa qepen, por me të njëjtën sipërfaqe;
  - c) vonesa në përfundimin e punimeve të apartamentit, i cili sipas palëve rezultoi në papërfunduar në vitin 2008, ndërkohë që duhet të ishte dorëzuar në maj të vitit 2006, sipas premtimit të shoqërisë ndërtuese dhe parashikimit të lejes së ndërtimit;
  - ç) mospërfundimi i punimeve të brendshme, pasi pllakat e apartamentit deklarohen të pashtuara në të gjithë sipërfaqen e tij.
53. Nga analiza e përmbajtjes së kontratës noteriale të sipërmarrjes së nënshkruar mes palëve në datë 31.05.2005, aktmarrëveshjes për marrjen e sendit në dorëzim, të nënshkruar më datë 15.05.2008 dhe kontratës noteriale të shitblerjes së apartamentit të nënshkruar më datë 25.10.2008, si dhe akteve bashkëlidhur dhe pjesë integrale e tyre, në referim edhe të konsideratave në paragrafin 49 (v) më sipër në vendim, trupi gjykues vëren se:
- (i) sendi i prenotuar sipas kontratës së sipërmarrjes është i njëjtë me sendin e blerë sipas kontratës së shitblerjes, dhe se pretendimi i deklaruar prej palëve në aktmarrëveshjen e datës 15.05.2008 për zvogëlim të sipërfaqes nuk është bindës, për sa kohë sipërfaqja e ndërtimit e kontraktuar në kontratën e sipërmarrjes së datës 31.05.2005, është e njëjtë me sipërfaqen e ndërtimit sipas kontratës noteriale të shitblerjes dhe se në planimetrinë që shoqëron kontratën e shitblerjes së apartamentit, sipërfaqja e ndërtimit evidentohet në mënyrë të dukshme nga ajo e shfrytëzimit<sup>36</sup>;
  - (ii) të metat e pretenduara në raport me specifikat e garazhit nuk krijojnë bindjen se mund të përbëjnë shkak për ndryshimin e çmimit të apartamentit, për sa kohë nuk provohet që garazhi të ketë qenë i përfshirë në negocimin e çmimit të apartamentit në kontratën e sipërmarrjes; dhe se
  - (iii) në lidhjen e aktmarrëveshjes dhe procesverbalit të marrjes në dorëzim nuk u provua të ketë pasur ndonjë arsye për dorëzimin e sendit të papërfunduar (të pashtuar me pllaka).
54. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik për caktimin e çmimit të apartamentit në kontratën e shitblerjes, në shkelle të detyrimit të vendosur sipas udhëzimit të përbashkët të ministrit të Financave dhe atij të Drejtësisë nr. 5, datë 18.01.2008, “Mbi tatimin për kalimin e të drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme”, trupi gjykues vëren se arsyetimi i subjektit të rivlerësimit është i drejtë dhe se akti nënligjor i ministrit të Drejtësisë dhe atij të Financave, i nxjerrë në zbatim të ligjit për tatimin mbi të ardhurat nuk ka për qëllim përcaktimin e çmimit të shitblerjes së pasurive të paluajtshme, apo kufizimin e palëve në lirinë e tyre për të përcaktuar lirisht brenda hapësirave ligjore, të drejtat dhe detyrimet e tyre kontraktuale, ndër to dhe çmimin e shitblerjes, por synon minimizimin e rasteve të abuzimeve në transaksionet e shitblerjeve të pasurive të paluajtshme, me efekt shmangien e detyrimeve tatimore. Për rrjedhojë, për sa kohë detyrimet tatimore janë paguar rregullisht nga palët e përfshira, pretendimi i Komisionerit Publik për parregullsi në përcaktimin e çmimit në kontratën e shitblerjes, lidhur me sa më sipër, nuk gjendet i bazuar.

<sup>36</sup> Referuar planimetrisë së apartamentit të banimit {\*\*\*}, kati i katërt i banimit, në kontratën e shitblerjes me nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.10.2008, para noteres N.K., apartamenti objekt gjykimi ka një sipërfaqe ndërtimi 117,5 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe shfrytëzimi 106,7 m<sup>2</sup>.

55. Në përfundim të analizës së mësipërme, në kuadër të shqyrtimit të pretendimit të Komisionerit Publik lidhur me pasaktësitë në deklarimet e subjektit të rivlerësimit të pasurisë së llojit “apartament banimi” në adresën: rruga “{\*\*\*}”, trupi gjykues vlerëson se, pavarësisht faktit që “Revokimi i kontratës” dhe “Aktmarrëveshja për dorëzimin e sendit” janë akte juridike të cilave nuk u cenohet vlefshmëria për shkak të formës, forma e tyre e shkresës së thjeshtë (private) dhe sjellja e palëve në raport me këtë pasuri nuk krijuan bindjen te trupi gjykues, lidhur me ekzistencën e vullnetit të palëve sipas përmbajtjes së këtyre akteve në datën e nënshkrimit të tyre dhe, për rrjedhojë, ato nuk u çmuan si akte të besueshme për Kolegjin në drejtim të përmbajtjes së tyre. Në përfundim, trupi gjykues arriti në konkluzionin se mospërputhjet e konstatuara mes deklaratës së pasurisë *vetting* dhe asaj periodike të vitit 2005, kësaj të fundit dhe kontratës së sipërmarrjes të datës 31.05.2005, lidhur me çmimin e apartamentit të banimit dhe pagesat e kryera për prenotimin e saj, nuk mund të justifikohen nga veprimet juridike të mëpasshme të pretenduara se kanë ndodhur mes palëve dhe, si të tilla, ato vlerësohen si deklarim i pasaktë i pasurisë në kuptim të nenit D, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës.
56. Sa i takon pretendimit të Komisionerit Publik mbi pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit për të justifikuar pagesat e kryera për prenotimin e apartamentit në vitin 2005 dhe prapësimin të subjektit të rivlerësimit se ky pretendim është i pabazuar për shkak se detyrimet që rridhnin nga kontrata e sipërmarrjes e datës 31.05.2005, nuk janë përmbushur prej subjektit, përfshirë dhe pagesa e deklaruar si e kryer në datën e lidhjes së kontratës së sipërmarrjes, trupi gjykues çmon të theksojë se - pavarësisht se nëpërmjet interpretimit logjik, për sa kohë prapësimi i subjektit të rivlerësimit nuk u arrit të provohet, kjo e vendoste atë në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar pagesën e këstit të parë - nuk u mjaftua vetëm me sa më sipër, por mori në shqyrtim edhe analizën ekonomiko-financiare të kryer për periudhën 1 janar 2005 - 31.05.2005, dhe pasi vlerësoi të gjitha pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me elementet e kësaj analize për këtë vit financiar, konstatoi se në datën në të cilën është paguar kësti i parë i çmimit të prenotimit të apartamentit prej 15.130 eurosh, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ishin në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për ta justifikuar atë në vlerën prej rreth 1.641.109 lekësh.
57. Në përfundim të analizës së hollësishme si më sipër, lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik për apartamentin e banimit, trupi gjykues arriti në konkluzionin se nga kontrolli lidhur me pasurinë e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit rezulton se ka kryer deklarim të pasaktë dhe se ndodhet në kushtet e pamjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme për të justifikuar këtë pasuri, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, pretendimi i Komisionerit Publik për konkluzion të gabuar të Komisionit lidhur me kontrollin dhe vlerësimin e pasurisë së paluajtshme (apartament banimi) gjendet i drejtë nga trupi gjykues dhe i bazuar në ligj dhe në prova.
58. *Në lidhje me shkakun e ankimit mbi verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të justifikuar krijimin e pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë vetting, trupi gjykues konstaton sa më poshtë.*
59. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakun të ankimit, në vijim të kërkesës së Komisionerit Publik, trupi gjykues me vendim të ndërmjetëm vendosi kryerjen e një analize ekonomiko-financiare nga Njësia e Shërbimit Ligjor të Kolegjit mbi të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e krijuara nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, për periudhën e rivlerësimit 2003-2016. Duke qenë se pjesë e analizës financiare ishte edhe përllogaritja e udhëtimeve jashtë vendit e subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të dhe në dosjen e administruar në Komision mungonin të dhënat lidhur me hyrje-daljet e fëmijëve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vendosi të

hetojë lidhur me këtë fakt, duke aksesuar bazën e të dhënave mbi hyrje-daljet nga territori i Republikës së Shqipërisë, sipas sistemit TIMS, për subjektin dhe personat e lidhur me të, për periudhën e rivlerësimit, në zbatim të parashikimeve të nenit 50, pikat 2, shkronja “ç” dhe 3 e ligjit nr. 84/2016.

60. Në datën 16.09.2019, palëve iu përcoll analiza ekonomiko-financiare<sup>37</sup> për subjektin e rivlerësimit Artur Malaj dhe personat e lidhur me të, për periudhën 2003-2016, pjesë integrale e së cilës ishte edhe Aneksi 1, analiza e zërit “Shpenzime për udhëtime jashtë Shqipërisë sipas sistemit TIMS, për periudhën 01.01.2003 – 31.12.2016”.
61. Sipas kësaj analize ekonomiko-financiare, u evidentuan çështjet e mëposhtme, për të cilat subjektin iu kërkua të jepte shpjegimet e tij.

**61.1.** Fitimet neto nga aktiviteti i noterisë së bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, për vitet 2008-2011, janë mbartur në vite si fitim i pashpërndarë dhe kanë qenë gjendje në arkën e personit fizik tregtar, deri në vitin 2011, kur rezultoi të jenë tërhequr në vlerën prej 9.550.000 lekësh, sipas zërit “Tërheqje pronari”, të raportuar në pasqyrat financiare të vitit 2011. Referuar të dhënave të mësipërme, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit) për vitet 2008, 2009 dhe 2010, fitimet neto nga aktiviteti i noterisë nuk i ka përdorur për ekonominë familjare. Në këto kushte, këto të ardhura nuk u morën në konsideratë në analizën financiare për vitet 2008, 2009 dhe 2010, për njësinë ekonomiko-familjare të subjektit të rivlerësimit.

**61.2.** Në deklaratën e interesave private periodike të vitit 2009, personi i lidhur (bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit) ka deklaruar një kursim në formën e likuiditetit *cash* në shumën prej 30.000 eurosh (konvertuar në 3.961.746,03 lekë) me përshkrimin “të ardhura nga aktiviteti i noterisë”, megjithëse fitimi neto i deklaruar prej saj në organet tatimore në vitin 2009 ka qenë në shumën 1.577.700 lekë, pra 2.384.046 lekë më pak nga kursimi i deklaruar. Fitimi neto nga aktiviteti i noterisë për vitin 2009 rezultoi i shtuar me 2.438.650 lekë, në korrik të vitit 2011<sup>38</sup>, si pasojë e legalizimit të kapitalit të kryer nga personi i lidhur, në kuadër të parashikimeve të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor” (në vijim “ligji nr. 10418, datë 21.04.2011”).

**61.3.** Për vitet 2005, 2008, 2009, 2010 dhe 2011, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë rezultuar me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara në këto vite.

62. Lidhur me analizën ekonomiko-financiare, Komisioneri Publik u shpreh dakord dhe nuk parashtrroi asnjë pretendim, ndërsa subjekti i rivlerësimit dha kundërshtimet e tij, si dhe deklaroi në seancë se këtyre kundërshtimeve u ka bashkëlidhur një akt ekspertimi kontabël, të nënshkruar prej tij dhe ekspertit që e ka përgatitur, të cilin e deklaroi si pjesë integrale të tyre. Gjithashtu, në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti i rivlerësimit paraqiti disa dokumente që kërkoi të pranohen si prova.
63. Në mënyrë të përmbledhur, kundërshtimet e subjektit të rivlerësimit ndaj analizës ekonomiko-financiare paraqiten si më poshtë.

*Lidhur me të ardhurat nga aktiviteti i noterisë së personit të lidhur*

<sup>37</sup> Ky dokument paraparak iu përcoll palëve në proces dhe iu nënshtrua shqyrtimit nga trupi gjykoës.

<sup>38</sup> Shih shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare të vitit 2011.

**63.1** Subjekti i rivlerësimit, në lidhje me çështjen e akumulimit të fitimeve nga aktiviteti i noterisë së personit të lidhur për vitet 2008, 2009 dhe 2010 dhe me deklarimin e zërit “Tërheqje pronari” me vlerë 9.500.000 lekë, sipas paraqitjes së tyre në pasqyrat financiare të vitit 2011 të personit fizik L.M., pretendoi sa më poshtë.

(i) Mospasqyrimi në bilancet e viteve 2008, 2009 dhe 2010 i tërheqjes së fitimit ka ardhur si pasojë e mungesës së detyrimit ligjor për një deklaram të tillë dhe parëndësisë që ka ky fakt në rastin e personit fizik, ndërsa deklarimi në bilancin e vitit 2011, në rubrikën “tërheqje e pronarit”, ka ardhur si pasojë e “konfondimit të kontabilistit”, duke e interpretuar pikën 4, të shtuar në vitin 2010 në nenin 33/1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” si detyrim edhe për personin fizik dhe, për rrjedhojë, në kuadër të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit pretendon se kontabilisti ka kryer rregullimet përkatëse në kontabilitet.

(ii) Deklarimi në zërin “Tërheqje pronari”, me vlerë 9.500.000 lekë, në bilancin e vitit 2011 është një gabim kontabël (material) i bërë nga kontabilisti që ka mbajtur pasqyrat financiare të bashkëshortes.

(iii) Në rastin e personave fizikë nuk ka asnjë rëndësi pasqyrimi apo mospasqyrimi në bilanc i tërheqjes nga pronari pasi të gjitha fitimet janë të pronarit dhe mosparaqitja në bilanc si tërheqje nuk ka asnjë ndikim tatimor për shtetin.

*Lidhur me legalizimin e kapitalit në vitin 2011, sipas ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, që lidhet me të ardhurat nga aktiviteti i noterisë së personit të lidhur për vitin financiar 2009.*

**63.2** Subjekti i rivlerësimit, lidhur me konstatimin e mësipërm, sqaroi dhe pretendoi sa më poshtë.

(i) Fitimi neto nga aktiviteti i noterisë për vitin 2009 është vendosur nga kontabilisti në vitin 2009, në vlerën 1.577.700 lekë dhe personi i lidhur, pasi ka ardhur në dijeni të këtij gabimi në korrik të vitit 2011, ka bërë rideklarim tatimor, duke shfrytëzuar një të drejtë ligjore të parashikuar nga ligji për procedurat tatimore dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, brenda afatit ligjor prej 36 muajsh nga data e dorëzimit të deklaratës fillestare. Sipas subjektit të rivlerësimit, rideklarimi është kryer në përputhje me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin nr. 10418, datë 21.04.2011. Gjithashtu, subjekti sqaroi se në kuadër të parashikimeve të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, personi i lidhur ka përfituar falje të një pjese të detyrimit tatimor në shumën prej 128.350 lekësh, e cila kërkoi t’i njihet si vlerë e shtuar në të dhënat për të ardhurat nga aktiviteti për vitin 2009, si vlerë e pashpenzuar.

(ii) Subjekti i rivlerësimit pretendoi se bashkëshortja e tij nuk bën pjesë në subjektet e përcaktuara si subjekte të përjashtuara, sipas parashikimeve të nenit 6 të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, nga të drejtat e parashikuara në kreun mbi legalizimin e kapitalit, duke qenë se ajo bën pjesë në kategorinë e personave fizikë dhe ligji përjashton vetëm kategorinë “individë”.

(iii) Subjekti i rivlerësimit pretendoi se rregullat e posaçme të parashikuara në kreun II të ligjit ku trajtohet në mënyrë të hollësishme çështja e faljes së detyrimit tatimor, në nenin 18 të tij nuk përjashtohen nga përfitimi i të drejtave sipas këtij kreu personat fizikë, por vetëm zyrtarët dhe personat juridikë në të cilët zyrtarët kanë aksione apo zotërojnë kuota në kapital.

(iv) Subjekti i rivlerësimit pretendoi se në të njëjtin konkluzion ka arritur edhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në shkresën e saj nr. {\*\*\*}, datë 01.10.2019, sipas së cilës, sipas përshkrimit të rastit të subjektit tatimpagues konfirmohet se ky i fundit ka qenë përfitues dhe zbatues i ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011.



*Lidhur me përllogaritjet mbi pagat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij, shpenzimet e udhëtimeve, dietave, interesave bankarë dhe shpenzimet e mobilimit:*

**63.3** Subjekti i rivlerësimit pretendoi se për vitet 2009 dhe 2011, në mënyrë të padrejtë nuk i janë llogaritur pagat e bashkëshortes në vlerat e deklaruara sipas shkresës së Drejtorisë së Sigurimeve Shoqërore Vlorë dhe asaj të Drejtorisë së Sigurimeve Shoqërore Tiranë, të cilat i paraqiti në cilësinë e provës. Subjekti pretendoi përllogaritje të gabuar edhe për pagat e tij, për vitet 2008 dhe 2009. Sipas subjektit të rivlerësimit, për vitin 2008 të ardhurat nga paga e tij janë 1.106.823 lekë dhe jo 1.060.881 lekë sa i janë përllogaritur, ndërsa për vitin 2009, të ardhurat nga paga pretendohen prej tij në vlerën 1.087.071 lekë dhe jo 1.076.371 lekë.

**63.4** Subjekti i rivlerësimit pretendoi se për disa udhëtime pune ai është ngarkuar me shpenzime edhe pse ato kanë qenë të mbuluara nga organizatorët, sikundër dhe nuk i janë llogaritur si e ardhur dietat e përfituara nga këto udhëtime, edhe pse kjo vjen në kundërshtim me ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”.

**63.5** Në lidhje me udhëtimet e tij dhe personave të lidhur me të jashtë Shqipërisë, subjekti pretendoi se shpenzimet për këto udhëtime në disa raste nuk janë përllogaritur sipas metodologjisë së miratuar nga Kolegji për trajtimin e udhëtimeve, shpenzimet e të cilave janë mbuluar nga të tretë, fakt për të cilin subjekti ka paraqitur dokumentacion provues.

**63.6** Subjekti i rivlerësimit pretendoi se në mënyrë të padrejtë nuk i janë llogaritur si të ardhura interesat bankarë edhe pse, referuar legjislacionit në fuqi, vlerësohen si të ardhura të ligjshme.

**63.7** Subjekti i rivlerësimit pretendoi se i janë llogaritur shpenzime mobilimi në mënyrë të gabuar, si pasojë e keqinterpretimit të përgjigjes së dhënë në Komision mbi shpenzimet e mobilimit për pesë vitet e fundit në vlerën 900.000 lekë, duke i llogaritur një shpenzim në vlerë të barabartë me 180.000 lekë për çdo vit, ndërkohë që subjekti pretendoi se ka shpenzuar gjithsej një vlerë prej 450.000 lekësh për vitet 2007-2010 dhe në mbështetje të këtij pretendimi paraqiti dhe prova.

**64.** Trupi gjykues, në vlerësim të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, lidhur me analizën ekonomiko-financiare për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, pasi mori në shqyrtim provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit në drejtim të shtimit të të ardhurave dhe reduktimit të shpenzimeve të përllogaritura, vlerësoi sa vijon.

**64.1** Sa u takon pretendimeve të subjektit të rivlerësimit për mospërllogaritje të pagave të bashkëshortes për vitet 2009 dhe 2011, trupi gjykues çmoi se një pretendim i tillë mund të merret në konsideratë vetëm në ato raste kur provohet nga subjekti i rivlerësimit se e ardhura nga paga për bashkëshorten e tij, e cila është e vetëpunësuar, është përfituar (tërhequr). Dokumentacioni i paraqitur në cilësinë e provës në këtë drejtim nga subjekti i rivlerësimit, konkretisht vërtetimet nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, provojnë faktin e pagimit të kontributeve të detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore mbi bazën e pagës së deklaruar në dokument, por nuk përbëjnë provë mbi përfitimin real (kalimin e vlerës së pagës së deklaruar nga të ardhurat e personit fizik tek individ i L.M.). Ky arsyetim i trupit gjykues mbështetet edhe nga dokumentacioni i administruar në fashikullin gjyqësor, ku konstatohet se në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin 2011, në rubrikën “Shpenzime personeli” është deklaruar vetëm vlera e paguar për siguracione (sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore), ndërsa në rubrikën që përfaqëson shpenzimet e personit fizik për pagat e personelit nuk është raportuar vlerë, konfirmuar kjo edhe në raportimet që i takojnë të njëjtit vit financiar në

pasqyrat financiare të vitit 2012. Ndërkohë, vihet re se në vitin 2010<sup>39</sup> personi fizik ka deklaruar shpenzime për paga në vlerën prej 193440 lekë, krahas atyre për siguracione, fakt ky që është mbajtur në konsideratë në analizën e Kolegjit, ku vlera e sipërcituar është llogaritur si e ardhur nga paga për bashkëshorten e subjektit. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit lidhur me përfitimin e pagave nga bashkëshortja e tij për vitet 2009 dhe 2011 u gjet i pabazuar në prova.

**64.2** Sa i takon pretendimit për përlllogaritje të gabuar të pagave të subjektit të rivlerësimit për vitet 2008 dhe 2009, trupi gjykues, pasi verifikoi vërtetimet e pagave të dorëzuara në cilësinë e dokumentacionit justifikues që shoqëron deklaratën e pasurisë, konstatoi se për vitin 2008, referuar vërtetimit të lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>40</sup> dhe vërtetimit të Shkollës së Magjistraturës<sup>41</sup>, të ardhurat nga paga neto të raportuara janë përkatësisht 957.561 lekë dhe 103.320 lekë, shuma e të cilave jep vlerën 1.060.881 lekë dhe jo vlerën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit prej 1.106.823 lekësh.

**64.3** Ndërsa për vitin 2009, referuar të njëjtit dokumentacion provues nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe vërtetimit të institucionit të arsimit të lartë<sup>42</sup> pranë të cilit ka qenë i angazhuar si pedagog i jashtëm subjekti i rivlerësimit, të ardhurat nga pagat raportohen përkatësisht 1.024.571 lekë dhe 107.000 lekë (si vlerë totale për vitin akademik 2009-2010), ku për pagën e përfituar nga angazhimi akademik është llogaritur përpjesëtimisht vlera prej 42.800 lekësh për 4 muaj angazhim gjatë vitit 2009. Për rrjedhojë, të ardhurat totale neto edhe për këtë vit arrijnë në vlerën 1.076.371 lekë dhe jo 1.087.071 lekë, sa pretendon subjekti i rivlerësimit.

**64.4** Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se përlllogaritjet e kryera nga Kolegji lidhur me pagat e subjektit të rivlerësimit, mbi bazën e dokumentacionit të dorëzuar prej tij në cilësinë e provës, janë të sakta dhe për sa kohë pretendimet e subjektit nuk mbështeten në prova, ato nuk pranohen nga trupi gjykues.

**64.5** Në lidhje me pretendimet e ngritura mbi përlllogaritjet e shpenzimeve për udhëtime jashtë Shqipërie, për arsye pune dhe për qëllime personale, trupi gjykues pasi shqyrtoi dokumentacionin e dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e provës, pranoi si të bazuara pretendimet e tij për zvogëlimin e shpenzimeve për vitet 2008, 2009, 2010 dhe 2011 në vlerën totale prej rreth 457.374 lekësh.

**64.6** Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit mbi dietat e përfituara, trupi gjykues në shqyrtimin e këtij pretendimi mban në konsideratë vendimmarrje të mëparshme të Kolegjit dhe rithekson se dietat janë vlera monetare të ofruara punonjësve/funksionarëve me qëllim përballimin/rimbursimin e shpenzimeve të shtuara, në kuadër të lëvizjeve jashtë qendrës së tyre të punës, me qëllim përmbushjen e detyrave të tyre dhe, në këtë kuadër dhe për sa kohë nuk provohet se dieta nuk është shpenzuar për qëllimin për të cilin është dhënë, por ajo është kursyer, nuk mund të llogaritet si e ardhur (te rubrika “Të ardhura/të hyra”) në ekonominë familjare të subjektit të rivlerësimit, për efekt të analizës së të ardhurave dhe shpenzimeve.

**64.7** Ndërkohë, lidhur me pretendimin mbi interesat bankarë, trupi gjykues pranon si të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se interesat bankarë janë të ardhura të ligjshme, në kuptim të burimeve të identifikuara nga legjislacioni në fuqi për tatimin mbi të ardhurat. Megjithatë, trupi gjykues konstatoi se përfshirja në tabelat e analizave financiare për secilin vit, e vlerave të

<sup>39</sup> Referuar pasqyrave financiare të vitit 2011, në kolonën ku jepen raportimet për vitin paraardhës, 2010.

<sup>40</sup> Vërtetimi nr. {\*\*\*} prot., datë 17.10.2016.

<sup>41</sup> Vërtetimi nr. {\*\*\*} prot., datë 18.10.2016.

<sup>42</sup> Shkolla Private e Arsimit të Lartë “{\*\*\*}”, Vlorë.

interesave bankarë<sup>43</sup> në rubrikën “Të ardhura në lekë”, pavarësisht se rrit “mundësinë për të kursyer” të subjektit të rivlerësimit, e lë të pandryshuar diferencën mes kursimit në total dhe mundësisë për të kursyer, për sa kohë interesat e akumuluar, në të njëjtën vlerë që do të shtoheshin në rubrikën e të ardhurave, do të shtoheshin edhe në rubrikën e kursimit “Gjendje në llogari/depozita”. Në këto kushte, trupi gjykues arrin në përfundimin se, pavarësisht se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i drejtë, mospërfshirja në përllogaritje e interesave bankarë nuk ka ndikuar në rezultatin final të analizës ekonomiko-financiare.

**64.8** Sa u takon pretendimeve lidhur me shpenzimet për mobilim dhe dokumentacionit të dorëzuar në mbështetje të këtyre pretendimeve, trupi gjykues fillimisht konstatoi se në analizën ekonomiko-financiare subjektit i janë llogaritur shpenzime mobilimi në të njëjtën vlerë totale, sa është deklaruar prej tij në Komision dhe për të cilat ai nuk kishte paraqitur ndonjëherë kundërshtime. Kundërshtimi i tij ndaj rezultateve të analizës financiare lidhur me shpenzimet e mobilimit, me pretendimin se këto shpenzime janë të përgjysmuara në vlerë, nga sa deklaruar fillimisht në Komision, duke dorëzuar në mbështetje të këtij pretendimi edhe një vërtetim të lëshuar nga z. A.M. në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, vlerësohet jobindës, për sa kohë konstatohet të jetë në kontradiktë me deklaramet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit në Komision, lidhur me vlerën totale të shpenzimeve të mobilimit dhe kohën e kryerjes së tyre. Për më tepër, trupi gjykues nuk arriti të krijojë bindjen se deklarimi i z. A.M. përbën provë të plotë të faktit që mobilimi është kryer nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, në vlerën e deklaruar në total prej 450.000 lekësh dhe se ky shpenzim është shpërndarë në vite sipas deklaramet, për sa kohë ky vërtetim nuk u shoqërua me dokumentacion justifikues financiar mbi faktet e pretenduara. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit në drejtim të zvogëlimit të shpenzimeve të kryera për mobilim, të deklaruara prej tij gjatë hetimit administrativ në Komision, mbetën të paprovuara.

*Lidhur me të ardhurat nga aktiviteti i noterisë së personit të lidhur*

65. Në lidhje me çështjen e të ardhurave të personit të lidhur nga aktiviteti i noterisë për vitet 2008, 2009 dhe 2010, trupi gjykues, pasi mori në analizë kuadrin ligjor të zbatueshëm mbi deklaramet e subjekteve tatimpaguese pranë organeve kompetente për efekt të vlerësimit të bazueshmërisë së pretendimeve të ngritura nga subjekti i rivlerësimit në paragrafët 63.1 (i) - (iii), vëren sa më poshtë.

**65.1** Në referencë të parashikimeve të nenit 29, pika 1 e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar deri në momentin kohor objekt vlerësimi, neneve 57, 64, pika 1 dhe 65, pika 4 e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë, nenit 3, pika 1, neneve 6, 7 dhe 18, pika 1 e ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit në ushtrimin e aktivitetit të noterisë si person fizik, i regjistruar pranë organeve tatimore, është personi përgjegjës për pasqyrat financiare të miratuara prej tij dhe të depozituara pranë organeve kompetente dhe, në këtë kuadër, legjislacioni i kërkon atij verifikimin e informacionit të paraqitur në pasqyrat financiare.

**65.2** Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se fitimet e realizuara në vitet 2008, 2009 dhe 2010 janë tërhequr realisht nga arka e personit fizik, mbeti i paprovuar, për sa kohë nuk u arriti të shpjegohet bindshëm se përse kjo vlerë e konsiderueshme monetare, e cila sipas raportimit në bilancin e vitit 2011 duhet të pasqyrohet gjendjen fizike të arkës së personit fizik, vërtet nuk ka qenë gjendje në datën e raportimit, sikundër pretendoi subjekti në kundërshtimet e tij, edhe pse është deklaruar e tillë.

---

<sup>43</sup> Këta interesa bankarë rezultuan të patërhequr.

**65.3** Referuar përmbajtjes fillestare të nenit 33/1 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i shtuar me ligjin nr. 9458, datë 21.12.2005, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, dhe përmbajtjes së këtij neni pas ndryshimeve të pësuara me ligjin nr. 10228, datë 4.2.2010, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, detyrimi për destinim të fitimit ka qenë dhe mbetet detyrim ligjor për personat juridikë. Përfshirja e personave fizikë në parashikimin e nenit 33/1, sipas tekstit të ndryshuar në vitin 2010, lidhet vetëm me aktin e miratimit të rezultatit financiar të vitit dhe detyrimin për depozitimin e tij pranë organit tatimor. Për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se ndryshimi i legjislacionit ka çuar në lajthim kontabilistin e miratuar, për të deklaruar tërheqjen (fiktive) nga pronari në pasqyrat financiare të vitit 2011, praktikisht në mars të vitit 2012, çmohet i pabazuar. Për më tepër, trupi gjykues vëren se, edhe nëse për një moment do të pranohej ky pretendim i subjektit të rivlerësimit mbi efektin e përmbajtjes së nenit 33/1 të ligjit të sipërcituar te kontabilisti, për sa kohë momenti i hyrjes në fuqi të normës ligjore që pretendohet se ka krijuar te ky i fundit bindjen për ekzistencën e një detyrimi ligjor, rezulton të jetë data 12.03.2010<sup>44</sup>, deklarimi i kontabilistit në zbatim të këtij detyrimi ligjor të perceptuar logjikisht do duhet të ishte kryer në pasqyrat financiare të vitit 2009, afati për depozitimin e të cilave përfundonte më datë 31.03.2010, rreth 18 ditë pas hyrjes në fuqi të normës së sipërcituar ligjore. Në kuptim të sa më sipër, deklarimi i kryer 2 vite më vonë nga hyrja në fuqi e parashikimit ligjor që pretendohet si shkak për kryerjen e një deklarimi fiktiv (tërheqje fitimesh) nga ana e kontabilistit, në vlerësim të trupit gjykues e bën të pabesueshëm këtë pretendim të subjektit të rivlerësimit.

**65.4** Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se në këtë rast ndodhemi përpara një gabimi kontabiliteti dhe jo para realitetit të një mbartjeje të fitimeve për periudhën 2008-2010 dhe tërheqjes së tyre në vitin 2011, në analizë të parashikimeve të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit<sup>45</sup>, trupi gjykues konstaton se referuar paragrafëve 85, 88 dhe 100 të SKK1, gabimet materiale të periudhave kontabël të mëparshme, në rastet kur ato do të korrigjohen në retrospektivë, do duhet të raportohen duke rregulluar tepricën e çeljes së fitimeve të pashpërndara. Gjithashtu, në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare do duhet të paraqiten (i) përshkrimi i gabimit material dhe (ii) efekti i korrigjimit të gabimit mbi zërat e bilancit dhe të pasqyrës së të ardhurave e shpenzimeve.

**65.5** Në vlerësim të sa më sipër dhe nga shqyrtimi i pasqyrave financiare të vitit 2011, për personin fizik L.M. konstatohet se nuk gjenden gjurmë të korrigjimit të gabimeve në raportimin e periudhave të mëparshme kontabël, lidhur me tërheqjen/mbartjen e fitimeve të realizuara në vitet 2008, 2009 dhe 2010 të cilat, siç pretendon subjekti i rivlerësimit, i kanë rritur në mënyrë fiktive fitimin e mbartur (të patërhequr) nga personi fizik. Nuk konstatohet as korrigjimi në zërin e fitimeve të mbartura në retrospektivë si parashikuar nga SKK1, çka do të sillte si pasojë korrigjimin e këtyre fitimeve në pasqyrat financiare të viteve 2009 dhe 2010 dhe pasqyrimin e këtyre korrigjimeve në periudhën në fjalë (vitin 2011, si dhe në informacionin krahasues të periudhës së mëparshme, vitin 2010 në rastin konkret). Gjurmë të këtij sistemimi të pretenduar nuk rezultuan

<sup>44</sup> Referuar nenit 6 të ligjit nr. 10228, datë 4.2.2010, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar, hyrja në fuqi parashikohej 15 ditë pas botimit të tij në Fletoren Zyrtare. Referuar bazës së të dhënave të Qendrës së Botimeve Zyrtare, ligji nr. 10228, datë 04.02.2010 është botuar në Fletoren Zyrtare me nr. 13, në datën 25.02.2010 dhe, për rrjedhojë, afati 15-ditor ka përfunduar më datë 12.03.2010.

<sup>45</sup> Standardet Kombëtare të Kontabilitetit janë miratuar me urdhrin e ministrit të Financave nr. 4292, datë 15.06.2006, “Për shpalljen e standardeve kontabël kombëtare dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre” dhe referohen në vijim në tekstin e vendimit me akronimin “SKK”, të ndjekur nga numri përkatës i standardit të referuar.

as në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare dhe, për rrjedhojë, trupi gjykues nuk arrin të bindet se veprimi i kryer është korrigjim i një gabimi material në kontabilitet, për sa kohë ai nuk duket të jetë kryer në përputhje me rregullat e përcaktuara në standardet e zbatueshme të kontabilitetit.

**65.6** Në përfundim të analizës si më sipër të kuadrit ligjor të zbatueshëm, bazuar në dokumentacionin që disponohet në fashikullin e çështjes, përfshirë çdo provë të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në Kolegj, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë pretendimet e tij lidhur me tërheqjen e fitimeve nga aktiviteti i noterisë së personit fizik L.M. për vitet 2008, 2009 dhe 2010. Kjo situatë dukshëm e vendoste subjektin e rivlerësimit në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të mbuluar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara në këto vite, si pasojë e moslogaritjes së të ardhurave nga aktiviteti i noterisë së personit të lidhur, si të ardhura në dispozicion të nevojave të njësisë familjare.

Pavarësisht sa më sipër, duke pasur parasysh që:

(i) qëllimi i kryerjes së analizës ekonomiko-financiare synon në radhë të parë verifikimin e vërtetësisë së deklarimit të subjektit të rivlerësimit mbi ekzistencën e burimeve të ligjshme të të ardhurave dhe mjaftueshmërisë së tyre për mbulimin e shpenzimeve të kryera dhe krijimin e pasurive të deklaruara, ku përdorimi apo mospërdorimi i të ardhurave të krijuara ndikon analizën e mjaftueshmërisë së burimeve;

(ii) për sa kohë përfundimi i mësipërm, mbi mospërdorimin e të ardhurave nga aktiviteti i noterisë për vitet 2008, 2009 dhe 2010, është rezultat i prezumimit të vërtetësisë së të dhënave të raportuara nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit pranë autoriteteve tatimore dhe analizës juridike të kryer lidhur me vlerësimin e bazueshmërisë së pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, pa pasur prova të faktit mbi tërheqjen fizike të vlerës monetare të deklaruar në zërin “tërheqje pronari në vlerën prej 9.550.000 lekësh” në vitin 2011; dhe se

(iii) fitimet nga ushtrimi i aktivitetit të noterisë përmbushin kriteret e përcaktuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nga neni 3, pika 19 dhe nga neni 30 i ligjit nr. 84/2016 për t’u konsideruar të ardhura të ligjshme dhe se referuar statusit të subjektit tatimpagues si person fizik, gjendja e mbartjes së fitimit financiar ndër vite, përveçse nuk passjell ndikim tatimor negativ për shtetin, as nuk i shërben personit fizik si arsye për të mos e bërë atë subjekt detyrimesh tatimore, në formën e tatimit nga të ardhura që rrjedhin nga fitimi i ortakut apo aksionerit, çka do mund të vlerësohej nga trupi gjykues si një justifikim i arsyeshëm për akumulimin e fitimit sipas raportimit në pasqyrat financiare;

– trupi gjykues, me qëllim arritjen e një vendimmarrjeje sa më të drejtë për çështjen, çmoi të arsyeshme që, pavarësisht një analize të kryer mbi bazën e të dhënave të deklarimeve të kryera nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit pranë organeve tatimore, të verifikojë situatën ekonomiko-financiare të subjektit të rivlerësimit dhe të personave të lidhur me të, për vitet objekt shqyrtimi, edhe në variantin e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, sikur këto të ardhura nga aktiviteti i noterisë të jenë tërhequr fizikisht nga arka e personit fizik dhe të jenë vënë në dispozicion të ekonomisë familjare, duke u përdorur për nevojat e saj.

**65.7** Nga verifikimet e kryera në analizën ekonomiko-financiare nëpërmjet shtimit në rubrikën “Të ardhura/të hyra” për vitet 2008, 2009 dhe 2010 të fitimeve të realizuara nga aktiviteti i noterisë së bashkëshortes së subjektit, rezultoi se situata financiare e subjektit të rivlerësimit dhe e personave të lidhur me të përmirësohet ndjeshëm, por sërish rezultati përfundimtar tregon pamjaftueshmëri

të burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara në një vlerë totale prej rreth 3.351.988 lekësh, për vitet 2008 dhe 2009<sup>46</sup>.

*Lidhur me legalizimin e kapitalit në vitin 2011, sipas ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, në funksion të rritjes së fitimit neto nga aktiviteti i noterisë së personit të lidhur për vitin 2009*

66. Në lidhje me çështjen e të ardhurave nga aktiviteti i noterisë së personit të lidhur për vitin 2009, të cilat referuar shënimeve shpjeguese të pasqyrave financiare të vitit 2011, janë shtuar me 2.567.000 lekë dhe se fitimi neto i personit fizik L.M. si pasojë e legalizimit të kapitalit në kuadër të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, është shtuar me 2.438.650 lekë nga fitimi i deklaruar fillimisht në vlerën prej 1.577.700 lekësh, trupi gjykues, pasi vlerësoi provat, mori në shqyrtim pretendimet e subjektit të rivlerësimit sipas paragrafëve 63.2 (i) - (iv) më sipër, çmon si më poshtë.

**66.1** Në lidhje me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se rideklarimi në tatime i personit të lidhur, në korrik të vitit 2011, është kryer në përputhje me procedurat e parashikuara nga ligji për procedurat tatimore dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, trupi gjykues pasi mori në analizë legjislacionin e zbatueshëm në kohë, konstaton se:

° Në kuadër të parashikimeve të nenit 64, pika 1 e ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (në vijim referuar “ligji nr. 9920, datë 19.05.2008”) në kombinim me nenin 29, pika 1 e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar dhe pikën 3.12 të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, subjekti tatimpagues (personi i lidhur) ka pasur detyrimin për të dorëzuar deklaratën e plotë dhe të saktë tatimore brenda datës 31 mars 2010 për rezultatet e vitit ushtrimor 2009.

° Referuar pikës 2 të nenit 64 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, lexuar në harmoni me nenin 65, pika 4 e të njëjtit ligj, tatimpaguesi (personi i lidhur) vetëdeklaroi shumën e detyrimit tatimor, nënshkruan deklaratën tatimore dhe konfirmon në përgjegjësinë e tij se deklarata është e plotë dhe e saktë. Referuar këtyre parashikimeve ligjore në fuqi, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se deklarimi i fitimit nga aktiviteti i noterisë për vitin 2009 ka qenë më i madh, por është deklaruar nga kontabilisti në vlerën prej 1.577.000 lekësh dhe se ky gabim i kontabilistit është konstatuar nga personi i lidhur në vitin 2011, nuk u arrit të provohet. Subjekti nuk dorëzoi asnjë dokumentacion justifikues, i cili të mund të provonte se deklarimi tatimor fillestar për vitin 2009, pavarësisht parashikimeve ligjore në fuqi, është kryer nga një person i ndryshëm nga bashkëshortja e tij.

° Në kuadër të parashikimeve të nenit 67 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, në fuqi në kohën e dorëzimit të deklaratës tatimore për vitin 2009, tatimpaguesi mund të dorëzonte një deklaratë të re tatimore, me ndryshime, në rastet kur deklarata tatimore fillestare ishte e pasaktë dhe me mangësi, brenda afatit kohor për ushtrimin e kësaj të drejte, sipas përcaktimit në pikën 2 të të njëjtit nen, që është dymbëdhjetë muaj nga afati i dorëzimit të deklaratës fillestare. Për rrjedhojë, e drejta e tatimpagueses L.M. për të dorëzuar një deklaratë tatimore të ndryshuar, sipas këtij parashikimi ligjor, ka humbur më datë 31 mars 2011, me kalimin e afatit dymbëdhjetëmujor nga data 31 mars 2010, që ka qenë afati i fundit për deklarimin e deklaratës fillestare.

**66.2** Në analizë të sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se pretendimi i subjektit të rivlerësimit që bashkëshortja e tij ka bërë rideklarim sipas nenit 67, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 dhe dispozitave përkatëse të udhëzimit të ministrit të Financave nr. 24, datë

<sup>46</sup> Konkretisht, rezultati financiar paraqitet me mungesë burimesh të ligjshme në vlerën prej rreth 440.782 lekësh për vitin 2008 dhe rreth 2.911.206 lekësh për vitin 2009.

02.09.2008, në zbatim të tij, është i pabazuar në ligj. Edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit se rideklarimi është kryer brenda afatit ligjor prej 36 muajsh nga data e dorëzimit të deklaratës fillestare, është i pabazuar, pasi ky parashikim ligjor rezulton që ka hyrë në fuqi më datë 30 nëntor 2016<sup>47</sup>.

**66.3** Në lidhje me pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me qenien apo jo të bashkëshortes së tij subjekt përfitues sipas dispozitave të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, trupi gjykues, në analizë të dispozitave të ligjit të sipërcituar, konstaton sa më poshtë.

◦ Referuar përkufizimeve të dhëna në nenin 3 të këtij ligji, “Legalizim i kapitalit” është *deklarimi vullnetar i bërë nga individë, shtetas të Republikës së Shqipërisë, persona fizikë të regjistruar si të tillë në organet përkatëse, apo përfaqësues të këtyre dy kategorive të mësipërme, për zotërimin e shumave në të holla, brenda ose jashtë vendit, si dhe pagimi i tarifës së bërë në institucionet përkatëse për depozitim të kësaj shume në një bankë të nivelit të dytë në Shqipëri [...]*. Në referim të procedurave ligjore për legalizimin e kapitalit sipas këtij ligji, vihet re se kushti ligjor për fillimin e procedurës së legalizimit të kapitalit, sipas përcaktimit në nenin 8 të ligjit, është deklarimi vullnetar nga subjektet e ligjit, se ata duan të legalizojnë vullnetarisht kapitalin, të cilin nuk e kanë deklaruar më parë, ose për të cilin më parë kanë deklaruar një vlerë më të vogël se ajo çfarë duhet të deklaronin.

◦ Sa u takon subjekteve përfituese nga legalizimi i kapitalit sipas këtij ligji, në nenin 5 përcaktohet shprehimisht: *Në rrethin e subjekteve, që përfitojnë nga procesi i legalizimit të kapitalit, përfshihen: a) personat fizikë apo juridikë, që deklarojnë, brenda kushteve të parashikuara nga ky ligj, shuma në të holla, dhe/apo diferencat pozitive që rezultojnë nga rivlerësimi i pasurive; b) individët, me shtetësi shqiptare, që deklarojnë brenda kushteve të parashikuara nga ky ligj, shuma në të holla.* Ndërsa në nenin 6 në vijim, parashikohet në mënyrë eksplicite: *Nga të drejtat e parashikuara në këtë kre, nuk përfitojnë ata individë, të cilët, në përputhje me legjislacionin e fushës, i nënshtrohen detyrimit ligjor për deklarimin e pasurisë pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.*

◦ Gjithashtu, referuar dispozitave të përgjithshme, konkretisht nenit 2, qëllimi i ligjit ndër të tjera është edhe mosfillimi apo ndërprerja nga ana e institucioneve përkatëse të administratës tatimore e doganore, të procedurave administrative dhe të nxjerrjes së vendimeve të kundërvajtjeve administrative të lidhura me fshehjen e të ardhurave dhe/apo mospagimin e taksave dhe të tatimeve ndaj këtyre subjekteve që legalizojnë kapitalin sipas këtij ligji. Ndërkohë që në dispozitën që përcakton raportin e parashikimeve të këtij ligji me ligje të tjera në fuqi, parashikohet në mënyrë të shprehur në pikën 2 të nenit 4 se ndërprerja e procedurave administrative, e përcaktuar në nenin 2 të këtij ligji, nuk zbatohet nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive.

◦ Procedurat e hollësishme për legalizimin e kapitalit sipas ligjit të sipërcituar janë përcaktuar në udhëzimin e ministrit të Financave nr. 12, datë 18.05.2011, “Për procedurat e zbatimit të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor”, i ndryshuar, sipas të cilit, referuar pikës 1.1, personi fizik tregtar apo përfaqësuesi i tij plotëson formularin e aplikimit. Sipas këtij formulari, në aplikimin e tij subjekti i këtij ligji konfirmon se të dhënat e shkruara në këtë aplikim janë të vërteta dhe deklaron se shumat në të holla që legalizon janë të fituara nga kryerja e evazionit fiskal. Në vlerësim të trupit gjykues,

<sup>47</sup> Miratuar me ligjin nr. 112/2016, datë 03.11.2016, dhe botuar në Fletoren Zyrtare nr. 219, datë 15.11.2016.

legjislacioni në fuqi lidhur me legalizimin e kapitalit ka qenë i qartë në drejtim të origjinës së të ardhurave që mund të legalizoheshin nga subjektet e ligjit, personi fizik në rastin objekt shqyrtimi.

° Pjesë përbërëse e këtij ligji është edhe kreu mbi faljen e detyrimeve tatimore dhe doganore në të cilin përcaktohen llojet e detyrimeve tatimore dhe doganore, të cilat falen sipas kushteve dhe kritereve të përcaktuara në ligj, subjektet që përfitojnë nga falja dhe ata të cilët përjashtohen nga të drejtat e parashikuara nga ky kre, ku konstatohet se në nenin 18, pika 3 e tij, përcaktohet shprehimisht: *Nga falja e detyrimeve tatimore e doganore përjashtohen zyrtarët që kanë detyrimin për deklarim të pasurisë, si dhe personat juridikë, në të cilët këta zyrtarë kanë aksione apo kuota kapitali.* Në referencë të dispozitave të këtij kreu, subjekti i rivlerësimit fillimisht, në seancën e datës 06.09.2011, deklaroi se në kuadër të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, bashkëshortja e tij kishte përfituar falje të një pjese të “detyrimit tatimor të pashlyer në vitin 2009, në vlerën prej 128350 lekësh”. Ndërsa në seancën në vijim, në datën 03.10.2011, ndryshe nga sa më sipër, pretendoi se “një pjesë e detyrimit tatimor të rritur si pasojë e rideklarimit tatimor në korrik të vitit 2011, në kuadër të të drejtave të ligjit për procedurat tatimore dhe brenda afatit ligjor prej 36 muajsh nga dorëzimi i deklaratës fillestare, u fal sipas parashikimeve të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011”.

**66.4** Në interpretim sistematik të kuadrit të sipërcituar ligjor e nënligjor, në vështrim edhe të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar<sup>48</sup>, sipas të cilave deklarimi i pasurive, i burimeve të tyre, i detyrimeve financiare bëhet sipas kërkesave të këtij ligji dhe se ky deklarim përfshin pasurinë e subjektit deklarues (zyrtarit) dhe të familjes së tij (bashkëshortit/es dhe fëmijëve madhorë), trupi gjykues arrin në konkluzionin se familjarët e subjektit deklarues, të cilët detyrimi i lind me ligj si pasojë e cilësimit “zyrtar”, sipas përkufizimit të dhënë në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, janë subjekte deklaruese dhe i nënshtrohen detyrimit ligjor për deklarimin e pasurisë pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, edhe pse jo sipas një cilësimi individual dhe të pavarur me zyrtarin, por si pjesë përbërëse e deklarimit të tij në kushtet e anëtarit të familjes.

**66.5** Në këto kushte, të gjithë ata individë të cilët kanë detyrimin për deklarimin e pasurisë pranë ILDKPKI-së, janë shprehimisht të përjashtuar sipas nenit 6 të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, nga të drejtat e parashikuara për legalizimin e kapitalit, pavarësisht nëse ata kryejnë aktivitet privat në formën e personit fizik, apo jo. Një zbatim i ndryshëm i kësaj dispozite do të passillte deformim të vullnetit të legjislatorit dhe zbatim të gabuar të këtij kuadri ligjor, për rrjedhojë, edhe trajtim të diferencuar të subjekteve të ligjit në fjalë. Për më tepër që kategorizimi i subjekteve përfituese sipas nenit 5 të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, në persona fizikë apo juridikë dhe individë me shtetësi shqiptare është bërë sipas kriterit të ushtrimit të aktivitetit tregtar, ndërkohë që sipas nenit 6 përcaktimi i subjekteve të përjashtuara nga dispozitat e ligjit në fjalë, është kryer sipas kriterit të të qenit subjekt/individ deklarues pranë ILDKPKI-së, në kuadër të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 dhe, për rrjedhojë, për sa kohë kuptimi i termit “individ” i përdorur në këto dy dispozita ligjore nuk përputhet, këto dy kategori nuk mund të ekuivalentohen. Për sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se bashkëshortja e tij përjashtohet nga zbatimi i nenit 6 të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, duke qenë se ajo bën pjesë në kategorinë e personave fizikë dhe jo në kategorinë “individë”, vlerësohet nga ana e trupit gjykues si pretendim i pabazuar në ligj.

**66.6** Me qëllim vlerësimit e pretendimit të subjektit të rivlerësimit për mospërfshirje të personit të lidhur në rrethin e subjekteve të përjashtuara nga të drejtat për legalizim të kapitalit, trupi gjykues

<sup>48</sup> Referuar tekstit të dispozitave të ligjit, me ndryshimet e pësuara deri në vitin 2011.



mban në konsideratë edhe parashikimin e pikës 2 të nenit 4 të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, sipas të cilit ndërprerja e procedurave administrative, e parashikuar në pikën 1, shkronja “a” e nenit 2 të këtij ligji nuk zbatohet nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive, çka konfirmon vullnetin e legjislatorit se dispozitat e ligjit mbi legalizimin e kapitalit nuk mund të afektojnë deklaramet e kryera nga subjektet e ligjit për deklarimin e pasurive pranë ILDKPKI-së, duke u garantuar atyre privilegje të natyrës së trajtuar më sipër.

**66.7** Edhe pse nga leximi literal i normës së përcaktuar në nenin 18 të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, mund të mendohet se vetëm zyrtarët si individë dhe personat juridikë në të cilët këta zyrtarë kanë aksione apo kuota në kapital nuk mund të përfitojnë nga të drejtat e këtij ligji, interpretimi telologjik i kësaj norme dhe ai sistematik të çojnë në të njëjtin konkluzion të drejtë se termi “zyrtar” nuk përfshin vetëm individin që është subjekt deklarimi pranë ILDKPKI-së, për shkak të detyrës funksionale që mban, por edhe çdo person tjetër të lidhur me të, pasuria, detyrimet financiare dhe interesat privatë të të cilit prekin në mënyrë të drejtpërdrejtë edhe zyrtarin, dhe si të tillë janë pjesë përbërëse e deklaramit të tij të pasurisë pranë organit kompetent. Mospërmendja në mënyrë të shprehur e personave fizikë në dispozitën e nenit 18, nuk duhet dhe nuk mund të çojë në interpretimin e gabuar se kjo kategori subjektësh deklarimi të pasurive pranë ILDKPKI-së, është shprehimisht e përjashtuar nga kufizimet e nenit 18, pika 3, për sa kohë ata janë të përfshirë në deklaramet e zyrtarit.

**66.8** Konkluzioni i mësipërm është shprehur në mënyrë të qartë edhe në përcaktimin e procedurës së faljes sipas nenit 19 të ligjit nr. 10418, në udhëzimin e ministrit të Financave nr. 12, datë 18.05.2011, ku në pikën 3, pjesa II.1, “Falja e detyrimeve tatimore”, paragrafi “c”, përcaktohet shprehimisht kompetenca e strukturave përgjegjëse për zbatimin e dispozitave të këtij ligji si vijon: *Drejtoria rajonale tatimore/zyra e taksave dhe tatimeve në bashki ose komunë, brenda 10 ditëve nga hartimi i listës së plotë të të gjithë debitorëve, detyrimi tatimor i të cilëve i përket periudhës tatimore deri më 31 dhjetor 2010, heq nga kjo listë personat fizikë të regjistruar si subjekte të taksës vendore të biznesit të vogël të përfshirë në listën e dërguar nga ILDKP-ja. Kjo listë e shkurtuar do të konsiderohet si lista finale mbi të cilën Komisioni do të vazhdojë procedurat e faljes.*

**66.9** Në përfundim të sa më sipër, vlerësohet i pabazuar nga trupi gjykues edhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit se referuar nenit 18, pika 3 e ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, bashkëshortja e tij nuk përjashtohet nga falja e detyrimeve tatimore, meqenëse nuk bën pjesë në kategorinë e zyrtarëve dhe as të personave juridikë të të cilët këta kanë aksione apo kuota në kapital.

**66.10** Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se në të njëjtin konkluzion me të ka arritur edhe Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në interpretimin e kuadrit ligjor lidhur me sa më sipër, sipas shkresës së saj nr. {\*\*\*} prot, datë 01.10.2019, vlen të mbahet në konsideratë se referuar shkresës në fjalë, nuk konstatohet të jetë bërë ndonjë interpretim ligjor lidhur me sa pretenduar nga subjekti i rivlerësimit, por është bërë vetëm një pasqyrim i parashikimeve ligjore dhe nënligjore lidhur me procedurën e deklaramit vullnetar të detyrimit tatimor, si dhe konstatimi i faktit se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka qenë përfitues i ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011. Më konkretisht, në përfundim të kësaj shkrese, konstatohet: *Referuar nenit 18 të ligjit të sipërcituar, ku përcaktohet, nga falja e detyrimeve tatimore e doganore përjashtohen zyrtarët që kanë detyrimin për deklarim të pasurisë, si dhe personat juridikë, në të cilët këta zyrtarë kanë aksione apo kuota kapitali dhe përshkrimin të rastit në shkresën tuaj konkludojmë se, ju keni qenë*

*përfituese dhe zbatuese e ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor", i ndryshuar.*

**66.11** Në përmbyllje të analizës së kuadrit ligjor mbi legalizimin e kapitalit dhe faljes së një pjese të borxhit tatimor, trupi gjykues në vlerësim të situatës faktike dhe shqyrtimit të hollësishëm të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë çështje, arrin në përfundimin se rritja e të ardhurës neto nga aktiviteti i noterisë së personit të lidhur për vitin financiar 2009, nuk ka ardhur si pasojë e procedurave standarde në kuadër të ushtrimit normal të veprimtarisë fitimprurëse të subjektit tatimpagues, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, por është rezultat i procedurave të kryera në kuadër të dispozitave të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor dhe doganor", i ndryshuar, për të cilat personi i lidhur në cilësinë e tij si subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së ka pasur kufizime ligjore, të shprehura në mënyrë eksplicite në ligjin përkatës.

**66.12** Lidhur me sa më sipër, trupi gjykues çmon të theksojë faktin që interpretimi i ligjit në kuadër të procesit të rivlerësimit kalimtar, për efekt të verifikimit të ligjshmërisë së burimeve të të ardhurave të subjekteve të rivlerësimit dhe personave të lidhur me ta është atribut i gjykatës (Kolegjit) dhe se çdo vendimmarrje e mëparshme administrative në këtë drejtim, për aq sa i takon objektit të kontrollit të organeve të rivlerësimit, nuk krijon imunitet në kuadër të këtij procesi, qëllimi i të cilit, ndër të tjera, është edhe identifikimi i rasteve kur subjektet e rivlerësimit në shfrytëzim të pozitës së tyre mund të jenë bërë përfitues të të drejtave apo përfitimeve në kundërshtim me parashikimet ligjore në fuqi.

**66.13** Edhe pse objekti i kontrollit të organeve të rivlerësimit në raste të tilla lidhet me vendimmarrje të cilat kanë prodhuar pasoja të caktuara juridike për palët e përfshira, vendimmarrja e Kolegjit në këtë drejtim nuk sjell pasoja në vlefshmërinë e këtyre akteve, por vetëm në drejtim të vlerësimit të ligjshmërisë së burimit të të ardhurave dhe pasurive të subjekteve të procesit të rivlerësimit, të cilat vijnë si rrjedhojë e këtyre akteve. Për pasojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se sipas interpretimit të organit tatimor bashkëshortja e tij është subjekt përfitues i ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011, dhe për rrjedhojë, të ardhurat neto të shtuara në vitin 2011 për vitin financiar 2009, në zbatim të dispozitave të këtij ligji, janë të ardhura të ligjshme, konsiderohet si pretendim i pabazuar në ligj.

**66.14** Në përfundim të sa më sipër, në analizë të fakteve të sipërpërmendura, rezultoi se të ardhurat nga aktiviteti i noterisë së personit të lidhur për vitin 2009, janë rideklaruar prej tij në datën 14.07.2011, duke shtuar fitimin neto për vitin financiar 2009 me 2.438.650 lekë, të ardhura këto, të cilat, referuar legjislacionit tatimor në fuqi, nuk ishin deklaruar më parë nga personi fizik. Në vijim të analizës së kuadrit ligjor në paragrafët pararendës, trupi gjykues vlerëson se vlera monetare e rideklaruar nga personi fizik L.M. në vitin 2011 përfshihej në objektin e legalizimit të kapitalit (si shumë në të holla e padeklaruar apo e deklaruar në vlerë më të vogël se ajo çfarë duhej të deklarohet), sipas procedurave të parashikuara nga ligji nr. 10418, datë 21.04.2011, por që referuar nenit 6 të ligjit të sipërcituar, personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit nuk mund të përfitonte pasi ishte subjekt i përjashtuar. Për rrjedhojë, rritja me 2.438.650 lekë e fitimit neto nga aktiviteti i noterisë për vitin 2009, nuk mund të konsiderohet si e ardhur e ligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuadër të kontrollit të pasurive të deklaruara në raport me ligjshmërinë e burimeve të tyre, trupi gjykues arrin në përfundimin se kursimi i deklaruar nga bashkëshortja e rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë periodikë të vitit 2009, në vlerën

prej 30.000 eurosh (konvertuar në 3.961.746,03 lekë<sup>49</sup>) nuk justifikohet me burime të ligjshme, për sa kohë të ardhurat e noterisë për vitin 2009<sup>50</sup>, të deklaruara si burim për krijimin e këtij kursimi, janë 2.384.046 lekë më pak.

67. Pas reflektimit në përlogaritje edhe të qëndrimeve të mbajtuara nga trupi gjykues ndaj pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, sipas konsideratave në paragrafët e mësipërm, nga rezultatet e analizës ekonomiko-financiare për subjektin e rivlerësimit, për periudhën e analizuar nga Kolegji (vitet 2003-2016), subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të rezultuan me pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për të justifikuar pasuritë e krijuara dhe shpenzimet e kryera, në vitet 2005, 2008, 2009 dhe 2011, në total, më së paku<sup>51</sup> në vlerën prej 5.804.318 (pesë milionë e tetëqind e katër mijë e treqind e tetëmbëdhjetë) lekësh<sup>52</sup>. Kursimet e krijuara në vitet me rezultat financiar negativ i kanë shërbyer subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të për krijimin e pasurisë së llojit likuiditet në sistemin bankar, të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe, për rrjedhojë edhe kjo pasuri e deklaruar, sikurse dhe apartamenti i banimit, nuk mund të justifikohet me burime të ligjshme.
68. Në përfundim të analizës së hollësishme lidhur me shkakun e ankimit të Komisionerit Publik për verifikimin e mjaftueshmërisë së burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, për të justifikuar krijimin e pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting*, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016. Për rrjedhojë, ky shkak i ankimit të Komisionerit Publik gjendet i drejtë nga trupi gjykues dhe i bazuar në ligj dhe në prova.
69. Në vijim të përfundimeve të arritura nga shqyrtimi i shkaqeve të mësipërme të ankimit të Komisionerit Publik, trupi gjykues çmon se konkluzionet lidhur me kontrollin e pasurive të deklaruara në deklaratën e pasurisë *vetting* janë të mjaftueshme për të arritur në konkluzionin përfundimtar lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë dhe vlerësimin se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të dhe, si pasojë, ndaj tij duhet të vendoset masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.
70. Në këto kushte, trupi gjykues e çmoi të panevojshëm analizimin e shkaqeve të tjera të ankimit dhe denoncimeve të publikut të paraqitura në Kolegj për subjektin e rivlerësimit, për sa kohë çdo konkluzion lidhur me to nuk do të arrinte të ndryshonte vlerësimin përfundimtar të trupit gjykues lidhur me këtë kriter të rivlerësimit dhe vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
71. Në përfundim të shqyrtimit të ankimit të Komisionerit Publik, për kriterin e vlerësimit të pasurisë, pas verifikimit të situatës faktike nëpërmjet analizës dhe çmuarjes së provave të administruara

<sup>49</sup> Sipas kursit mesatar vjetor të vitit 2009, referuar arkivit të Bankës së Shqipërisë:

[https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi\\_zyrtar\\_i\\_kembimit/Arkiva\\_e\\_kursit\\_te\\_kembimit/](https://www.bankofalbania.org/Tregjet/Kursi_zyrtar_i_kembimit/Arkiva_e_kursit_te_kembimit/)

<sup>50</sup> Deklaruar pranë organit tatimor për vitin 2009 në vlerën prej 1.577.000 lekësh.

<sup>51</sup> Referuar analizës ekonomiko-financiare në skenarin e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit sikur të ardhurat nga aktiviteti i noterisë së bashkëshortes së tij për vitet 2008, 2009 dhe 2010 janë tërhequr dhe janë përdorur për nevojat e ekonomisë familjare të subjektit të rivlerësimit.

<sup>52</sup> Ky rezultat financiar paraqitet si shumatore e viteve me rezultat financiar negativ, si vijojnë:

- për vitin 2005, në vlerën -1.641.109 lekë, lidhur me pagesën e kështit të parë për prenotimin e apartamentit të banimit;
- për vitin 2008, në vlerën -440.782 lekë;
- për vitin 2009, në vlerën -2.911.206 lekë; dhe
- për vitin 2011, në vlerën -811.221 lekë.

gjatë procesit të hetimit nga Komisioni, akteve të administruara nga hetimi gjyqësor i kryer nga Kolegji, dëgjimit të parashtrimeve të palëve në seancë gjyqësore publike, në analizë të legjislacionit të zbatueshëm, sipas parashikimeve në fuqi në kohën në të cilën kanë ndodhur faktet e provuara gjatë hetimit,

**trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,  
bazuar në analizën e mësipërme, arrin në këto konkluzione:**

1. Lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk arriti nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurive të deklaruara, pasi ka bërë deklaram të pasaktë dhe të pamjaftueshëm të pasurisë së tij dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
2. Për rrjedhojë, kërkitimi i Komisionerit Publik për ndryshimin e vendimit nr. 62, datë 03.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, duhet pranuar.

**PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës, në nenin 61, pika 3, si dhe në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

**VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 62, datë 03.08.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Artur Malaj.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.  
U shpall sot, më datë 24.10.2019, në Tiranë.

**ANËTAR**

**Luan DACI**

*nënshkrimi*

**ANËTAR**

**Ardian HAJDARI**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**RELATOR**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*

**KRYESUESE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*